

NO SITI

E përjavshme Informativ (Nr. 454) 12 - 25 Janar 2009 Çmimi 20 Lekë

Shtypshkronja
D.I.J.A.-Poradeci
Tel: 003558322905
Mobil: 00355682158284



Të jesh Lider...

Fjala e mbajtur më 10 dhjetor 2008, Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, në 5-vjetorin e shoqatës "Unë, Gruaja"



Borë në Pogradec

Tradita

Kush e fotografoi "Mësonjëtoreshën e Parë Shqipe"



Ajo është fotografi e vetme që kemi tani për atë qendër arsimore që lojti një rol aq të rëndësishëm për mësimin e gjuhës shqipe

Lexoni në faqen 7

Opinion

Pogradeci: një qytet-ide?



Qytetarët, nuk janë të gjithë mirëfilli aktorët kryesorë të risive kulturore, madje as të konsumit të tyre.

Lexoni në faqen 4

Reportazh

Prag-dimri zbret në Pogradec

Nga Ben Andoni

Eshtë pak si shumë i stërmadh, monumenti i Lasgush Poradecit në lulishten në qendër të qytetit të Pogradecit. Bronzi duket se e ka veshur dy herë poetin më të madh lirik të shqiptarëve, që i qëndron si brinjazi sërish të gjithave. Ai vetë, me pallton post-mortem, edhe më të stërmadhe, vigjilon mbi liqen. Nuk lëviz asgjë. Sipër tij qielli, kujdeset mbi qytetin dhe mbi këtë mrekulli të natyrës. Kështu e gjejmë ne, në këtë muzg vjeshte dhe ashtu dhe kjo mori njerëzish, që kanë ardhur për të kaluar një fundjavë në këtë qytet. Parkohet te ish-turizmi dhe pastaj për 10-20 minuta ke mundësi të pushtosh të gjithë qytetin. Është ndërtuar një rrugë e bukur pedonale në qendër, ndërsa makinat në rrugët pak më tej kuisin në një anarki lokale trafiku. Në breg janë ulur disa shpendë të stërbardhë. Duhet të hanë. Duhet edhe ne të hamë. Një grup i organizuar shkodranësh me nxënësit e tregon hapur këtë urgjencë. "Aj...e ka dit' komandanti. Boll ke i kuartë, ku me e ba rehatin. Kam vite që s'jam rehatu kshu", u thotë kolegëve të tij mësues, një 55 vjeçar pa flokë. Anash, tre kolege të tij e përqeshin, ndërsa në tavolinë me ton kreshendo po batërdisin burrat e tyre dhe...kuptohet vjehrrat. Neve na ka grishur, një burrë, pak minuta më vonë. Na afron menyne dhe na lë t'i kënaqemi restorantit të tij familjar, që i ka vendosur emrin e poetit. Diku, i ndjeri, është vetë në foto. Pronari-kuzhinier na lë të këqyrim, ndërsa vetë zhduket sakaq pas një si kthinë. Ka ngritur një lokal në pronën shtëpiake, në një nga rrugicat që është kthyer mrekullisht në identitet. Është Gusho. Me racën e ka ndarë pak si shumë çuditshëm, shtëpinë, që u ka lënë i ati.

Lexoni në faqet 8-9



BANKA POPULLORE

SOCIETE GENERALE GROUP

Rezervuarët e ujit nën kontroll

Reshjet e fundit kanë tejngopur rezervuarët dhe moskujdesi në kontrollin e sasisë së tepërt të ujit të grumbulluar, përbën rrezik të shpërthimit të digave dhe përmytje. Në rrethin e Korçës janë 12 rezervuarë, të cilët po ruhen nga punonjësit pasi u mbyllën rubinetat e derdhjes së ujit të tepërt. Drejtori i Bordit të Kullimit, Gentjan Pere shprehet se në 12 rezervuarë sasia e ujit të mbledhur nga rënia e reshjeve të fundit përbën një rrezik, nëse nuk mbahet nën kontroll niveli mbajtës i ujit.

Në disa raste ka patur zënie të saraqineskave nga banorët dhe ne kemi ndërhyrë për t'i hapur që të derdhet sasia e tepërt e ujit të grumbulluar nga reshjet e

fundit. Janë ngritur grupet e punës dhe janë vënë në gatishmëri për të menaxhuar situatën si në rezervuarë ashtu dhe në prurjet e lumenjve, ku matim lartësinë e tyre dhe po mbajmë në gatishmëri kanalet kryesore të fushës së Maliqit.

Ndryshe nga vitet e tjera kur ka patur përmytje, deri tani ky fenomen është shmangur. Ndërhyrja për të boshatisur ujët e tepërt është e domosdoshme këtë vit, pasi në dimrin e kaluar nuk pati reshje dhe nuk u krijuan probleme me sasira të tepërta të ujëmbledhësve. Masa të tilla merren që të ruhen rezervuarët dhe të shpëtojmë zonat e banuara nga përmytjet, për të eliminuar shpërthimin e digave mbajtëse dhe mbrojtëse.

Fëmijët romë marrin dhurata

Për 90 fëmijë romë ka qenë ditë gëzimi marrja e një çante me dhurata të bëra nga mitropolia e Korçës. Dhuratat kanë qenë pak me vonesë, por fëmijët kanë mbajtur të ndezur atmosferën e vitit të ri. Mitropolia edhe një ditë më parë dha dhuratë për 50 fëmijë jetimë. Dhuratat i ndau vetë mitropolit i Korçës Imzot Johani. Për çdo vit ai ka dhënë dhurata për fëmijët rom si pjesë e pandashme e qytetit të Korçës.

Në emër të fëmijëve romë përshëndeti Arben Kosturi si kryetar i shoqatës Amardrom. Nuk i ka lënë për çdo vit fëmijët e komunitetit tonë pa shpërndarë dhurata mitropolia. Për të mos u ndier të diskriminuar, fëmijët morën dhuratat që dëshironin. Këta janë fëmijë që kanë nevojë për ndihmë dhe mbështetje, u shpreh Kosturi.

Rruga e Voskopojës nxjerr viktimat

Kthehet nga Greqia pasi mbaron dënimin me burg për trafik narkotikësh. Por qëndron pak kohë në shtëpi dhe që prej dhjetë ditësh ishte larguar prej banesës në lagjen 6 të qytetit të Korçës. I deklaruar i humbur nga familjarët është gjendur si kufomë në rrugën që të çon për në Voskopojë, i vrarë me armë zjarri. Pëllumb Çollaku emigrant në Greqi, i kthyer për pushime pas një mungese prej dhjetë ditësh në banesën e tij, ka alarmuar familjarët, të cilët kanë shpallur humbjen e tij, pasi nuk kanë patur asnjë kontakt me të. Familjarët kanë njoftuar policinë, por kanë qenë kalimtarë të rastit në rrugën



që të çon për në Voskopojë, që kanë gjetur një kufomë mashkulli.

Policia e lajmëruar nga banorët

ka shkuar në vendin ku pushonte kufoma. Nga hetimet e para ajo ka konstatuar se kufoma i përkiste 25-

vjeçarit Pëllumb Çollaku. Trupi i pajetë është gjendur në anë të rrugës. Pasi ka shkuar policia ka kërkuar dhe ndihmën e familjarëve për të bërë identifikimin. Nga konstatimet e para mendohet se kemi të bëjmë me një vrasje të ndodhur para disa ditëve dhe trupi është lëvizur nga vendi i krimit. Ai nuk është paraqitur në banesë që prej dhjetë ditësh. Pak kohë kish që ishte kthyer nga Greqia. Policia po punon për zbardhjen e motivit të vrasjes dhe është vënë në kërkim të gjetjes së autorit të ekzekutimit. Para disa muajsh në rrugën e Voskopojës u gjend trupi i Kosta Trebickës.

Dy banorë të rinj në orët e para të ndërrimit të viteve

Një djalë e një vajzë kanë ardhur në jetë pak minuta se të ndërroshin vitet në qytetin e Korçës. Djali ka gëzuar një familje që e priste pas katër vajzash, ndërsa vajza ka qenë fëmija e parë e një familje të re. Luljeta Guri nga fshati Podgorie bëhet nënë për herë të parë, ndërsa Vjollca Hoxhalli nga fshati Vashtëmi, pas katër vajzave sjell në jetë djalin, trashëgimtarin e familjes. Të dyja nënat kanë bërë lindje normale.

Ngricat, nisin viktimat e para

Të gjymtuarit nga ngricat nisen drejt spitalit për të marrë ndihmën e parë dhe hedhjen në allçi të kockave të thyera. Viktimat e para nga akulli janë fëmijët dhe pleqtë. Në spitalin rajonal të Korçës janë paraqitur deri tani tre fëmijë dhe dy të moshuar të gjymtuar nga shkarja dhe humbja e ekuilibrit në lëvizjet mbi sipërfaqet e akullta. Në spitalin e Korçës vijnë të lënduar nga ngricat që nga Leskoviku i largët, Erseka, Pogradeci, Devolli, pasi në këto spitale nuk ka mjek ortoped.

Për rastet ku ka dëmtime të rënda e të vështira pacientët viktimat nisen për në spitalin ushtarak në Tiranë. Por nuk mungojnë raste që përcillen në spitalet e Maqedonisë dhe të Selanikut. Të dëmtuarit nga frakturat e akullit nuk kanë munguar asnjë vit. Në



dimrin e 2004 numri arriti në 54. Dimri me më pak viktimat nga akulli ka qenë dimri i vitit 2008. Me gjithë këshillat e herëpashershme që jepen për të moshuarit dhe për fëmijët që të mos dalin në orët e para të mëngjesit, kur ngricat dhe akulli janë në pikun e tyre prapëseprapë ata dalin dhe pësojnë aksidente, ku ka patur edhe raste me pasoja të rënda për jetën.

Afroviti GUSHO

...sepse të gjithë duam që gratë më të mira t'i kemi atje, të ndikojnë vendimmarrjen në të mirë të jetës sonë



Të jesh Lider...

Fjala e mbajtur më 10 dhjetor 2008, Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, në 5-vjetorin e shoqatës "Unë, Gruaja".

Nuk besoj se do ndodhë ndonjëherë tjetër në jetë, të jem në një pozitë kaq të vështirë si sot. Këtu, përpara këtij auditori unë duhet të diskutoj për shoqërinë civile dhe liderët.

Mendova ta bëja me shkrim këtë përshëndetje, mirëpo deri ditën e fundit me organizatoret e këtij aktiviteti, Norën dhe Nexhin kemi patur shumë debate.

Unë kam qenë krejt kundër kësaj mënyre promovimi të liderit në një përvjetor të shoqatës "Unë, Gruaja". Fakti që nuk ndikova në këtë vendimmarrje nënkupton që liderin e kanë lenë fuqitë dhe është fundi, koha për t'u larguar...

Mendoj që bëmë shumë debate të cilat do na vlejnjë për të ardhmen.

Prezantimi i Norës së bashku me këta fëmijët e mrekullueshëm këtu, mënyra sesi ata sollën çdo arritjen time dhe të shoqatës "Unë, Gruaja" është mbresëlënëse. Por kuptohet që ndonjëherë vlerat e krijuara nga shumë njerëz i vishen një njeriu, liderit. Pastaj mendova, po edhe sikur ta shohim nga ana e kundërt, që të dilja unë dhe të të flisja për veten, askush s'do të besonte që i kisha unë këto vlera, nëse nuk ke njerëz që bashkohen me ty, për qëllime të

përbashkëta. Kështu që kjo punë teorikisht është e komplikuar dhe e pashpjeguar deri më sot. Unë di vetëm që duke koontribuar nëpërmjet kësaj shoqate, përmes projekteve që kemi realizuar të gjithë bashkë, unë jam bërë lider i sukseshëm. Kjo duke pasur ndihmën e shumë bashkëpunorëve që sot janë në këtë sallë dhe unë për këtë jam shumë e lumtur, sepse ata e dinë shumë mirë, pasi kanë qenë afër shoqatës sonë, dinë shumë mirë se çfarë ne kemi bërë së bashku, çfarë suksesesh kemi arritur. Besoj që do të na i falni këtë moment, që kur bëja shaka me koleget e mia thosha: ja kështu krijohet, është kulti i individit, i marrim meritat e ia veshim një njeriu..., e kemi mësuar që në kohën e para '90-ës. S'kam qenë dakort as për stendën që u bë aty, megjithëse u munduam të vinin më shumë fjalën shoqata "Unë, Gruaja" sesa Afroviti.

Ky vit, 2008-ta ka qenë i veçantë, pasi është pesë vjetori i shoqatës. Ka qenë një vit, që na është dashur të kontribuojmë për të ecur përpara. Shoqata jonë është e përbërë nga shumë anëtare gra, shumë bashkëpunorë në qytet dhe në fshat. Kjo ka qenë besoj pika më e fortë që kemi pasur ne, kemi bërë pjesë të

projekteve tona ekspertë të fushave të ndryshme, që e kanë ndihmuar shoqatën me konsulencën e tyre.

Ne si shoqatë kemi filluar punën me dhunën në familje. Do thoni ju sa e kemi arritur?

Sot është 10 dhjetori. Gjithmonë këto ceremonitë tona kanë sjellë këtu një konkurs eseje për dhunën, të

”

...dhe sidomos t'i jap gjithë meritën që i takon shoqërisë civile, sepse besoj që në Shqipëri, shoqëria civile ka arritur të bëjë gjëra shumë të mëdha

”

luftojmë me moton "Ndal dhunës". Kemi arritur shumë për të sensibilizuar të gjithë komunitetin për luftën kundër dhunës, por nuk është se ajo ka mbaruar. Pak ditë më parë në shoqatën tonë ka ardhur një grua e dhunuar me shenja në fytyrë dhe nuk kishte pasur njohuritë e nevojshme për të përdorur ligjin e sapo dalë. Mbrëmë kam dëgjuar në familjen time një

histori që tregonte po për një grua të rrahur në Pogradec, një moshataren time... Dhe një ditë para këtij aktiviteti u bëra shumë pesimiste duke imagjinuar dhe sa rrugë tjetër kemi për të bërë, për t'i thënë ndal dhunës.

Njëkohësisht të gjitha kemi kuptuar se duhet të kishim gra shumë më të fuqishme që të jenë atje ku merren vendimet, të ndryshojnë ligjet. Ne i kemi promovuar gratë tona, pastaj na i ka marrë politika.

Shpresoj nuk na vjen keq, sepse të gjithë duam që gratë më të mira t'i kemi atje, të ndikojnë vendimmarrjen në të mirë të jetës sonë.

Sivjet, në një shkollë të NDI, që kemi bërë, e që unë i them shkollë shkollë partie, sepse përgatit lidera për në politikë, kemi mësuar shumë gjëra, kemi vendosur atje së bashku, të nxisim pjesëmarrjen e gruas në politikë, dhe besoj që do të jemi ne të parat që do ta japim këtë kontribut.

Unë mendoj që i kam një borxh shumë të madh shoqërisë civile, që kam filluar para dy muajsh ta shlyej nga pak këtë borxh, duke filluar një rubrikë në revistën "Psikologjia" "Hapësirë Civile".

Atje, mendoj, që çdo muaj, me këtë rubrikë të sjell gjithë eksperiencën time dhe sidomos t'i jap gjithë meritën që i takon shoqërisë civile, sepse besoj që në Shqipëri, shoqëria civile ka arritur të bëjë gjëra shumë të mëdha.

Të gjithë jemi të përfshirë në të...

Nuk mendoj që ndonjëherë do të dalim nga ky qerthull i shoqërisë civile, por gradualisht po iu lëmë vend më të rinjve që të përfshihen nëpër shoqata, ata do të bëjnë projektet që ne i kemi lenë përgjysëm...

Në qoftë se do ta kisha bërë me shkrim këtë fjalë, do të përdorja disa citate nga libri "Manual i luftëtarit të lirisë", të Pablo Coelho, të cilin vërtet ua rekomandoj ta lexoni.

Në shumë momente të vështira të jetës sime e hap dikë, kudo që të jem. Është një udhërrëfyes për të kapërcyer pengesat që kemi përpara. Dje, e shfletova për hetë të fundit para këtij aktiviteti dhe mendova që të përdor diçka.

Nuk mund të sjell këtu 300 faqe që është ai libër, por mendova shumë mirë, që togfjalëshi "luftëtari i dritës", mund të përdoret për të gjithë njerëzit, që kanë qenë në shoqërinë tonë, të gjithë njerëzit që kanë bashkëpunuar me shoqatën tonë dhe që na kanë ndjekur. Them që të gjithë së bashku jemi "luftëtarë të dritës", për të sjellë mirësi në këtë vendin tonë.

Faleminderit!

Më mirë të kemi më shumë lexues të mirë, se sa më shumë poetë të dobët

Ana Kove

Qytetarët, nuk janë të gjithë mirëfilli aktorët kryesorë të risive kulturore, madje as të konsumit të tyre; ata janë më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve të jetës së tyre materiale dhe, nëse qëllon që në të të ketë rol kultura, atëherë, ndoshta po, do të mund të themi se është ngacmuar sadopak interesi i tyre në lidhje me kulturën. Do të përmendja një nga hallkat e zinxhirit të materializmit kulturor, që është edhe në interesin e lexuesit të Nositit, pra, në efektet që ka e ashtuquajtura superstrukturë kulturore (ku futen idetë, arti, letërsia, informimi, shkenca, muzika, sporti etj.), mbi infrastrukturën (efektet e prodhimit, që përcaktojnë mënyrën e jetesës) dhe strukturën (ku futen të gjitha llojet e organizimeve dhe grupeve që përcaktojnë struktura të ndryshme, si atë, politike, ekonomike, të familjes etj.)

Është infrastruktura dhe zhvillimi i saj, në fakt, ai që kushtëzon zhvillimin e strukturës dhe superstrukturës socio-kulturore. Kështu do të mund të merrte kuptim pyetja: Si të ndërmjetësojmë, që resurset superstrukture të këtij qyteti, të mund të ndikojnë në zhvillimin kulturor dhe, rrjedhimisht, edhe në elementët e infrastrukturës dhe strukturës së tij. Kjo mendoj unë e tejkalon paksa forcën tonë, jo për të dhënë ide, por për të ndikuar me idetë tona në ndryshimin real të gjëndjes. Kjo, jo se unë jam flamurtare e materializmit kulturor e se nuk besoj se kultura dhe zhvillimi i saj mund të ndryshojë dhe zhvillojë jetën materiale, pasi unë dhe të gjithë miqtë e mi i takojmë atij grupimi, që e kemi mbështetur mirëqenien tonë, pra, si të thuash, infrastrukturën tonë jetësore, mbi shfrytëzimit e aftësive tona individuale të ashtuquajtura "superstrukture", sipas konceptit të mësipërm. A mund të pretendohet mbërritja e qëllimit, duke i grishur gjithë njerëzit të merren me kulturë? Është njësoj si të pretendosh të shuhen luftërat, duke luftuar e përpjekur të shndërrohen gjithë njerëzit në pacifistë. Kjo përpjekje nuk është pa efekte dobiprurëse, por nuk është e plotë. E meqë punojmë gati

*Gjithmonë kam sjellë
ndërmend vendlindjen,
Pogradecin tim,
Pogradecin tonë. Ky qytet
i vogël, madje edhe më i
bukur nga natyra se
Vajmari, ka fatin e keq, që
shteti të mos e shpallë
monument natyror liqenin,
që po i rrezikohet ngjyra,
as mëshsteknat, unapkat
shekullore dhe pemët e
tjera dekorative që
frymëzuan lirikën e
papërsëritshme të
Poradecit.*



Pogradeci: një qytet-ide?

individualisht, gjithsekush në fushat tona ose në grupe, unë mendoj të ndalem përsëri te roli i individit. Në këtë vend politikat kulturore i hartojnë njerëz që kanë shumë pak lidhje me kulturën, madje lidhje të pasinqerta dhe me politikën si të tillë, e një pjesë e mirë e jona, për arsye që nuk është se nuk i dimë, nuk do të jemi edhe për shumë kohë hartues të tyre. Unë do mundohem t'i mbaj këmbët në tokën time dhe të pyes "Si mund ta zhvillojmë ne, o njerëz, qytetin tonë?"

Sa herë e kam përsëritur me mendje, dhe tani me zë, këtë pyetje, më është kujtuar Vajmari. Qyteti i vogël gjerman, model i zhvillimit, përmes shkëlqimeve kulturore. Kryeqyteti i kulturës europiane disa herë. Një qytet aq të vogël, me më pak se 60 mijë banorë, por me mbi 400 000 turistë në vit, (këtu të pallogaritur turistët ditorë Vajmari është jo vetëm një qytet, por një qytet-ide. Goethe dhe Schiller jetuan e punuan atje - historia e letërsisë gjermane ka atje gurin e saj më të rëndë të themelit. Po kjo mund të thuhet për muzikën, përmes emrave të Johan Sebastian Bach, Franz List; filozofit Nietzsche e Jochan Gottfried Herder; piktori Cranach, arkitekti Walter Gropius, princesha Anna Amalia, me bibliotekën e saj të famshme, princi, njëkohësisht romancier dhe themelues i teatrit të oborrit Christof Martin Wieland dhe

për të ardhur tek Jean Paul, Johana Schopenhauer, Max Liebermann, dhe emra të tjerë pafund. Emra që i dhanë emrin dhe shkëlqimin qytetit me madhësinë dhe gjenialitetin e tyre.

Sa herë kam qenë atje, gjithmonë kam sjellë ndërmend vendlindjen, Pogradecin tim, Pogradecin tonë. Ky qytet i vogël, madje edhe më i bukur nga natyra se Vajmari, ka fatin e keq, që shteti të mos e shpallë monument natyror liqenin, që po i rrezikohet ngjyra, as mëshsteknat, unapkat shekullore dhe pemët e tjera dekorative që frymëzuan lirikën e papërsëritshme të Poradecit, siç bëhet me pemët e Gingo Bilobës, që frymëzuan Goethen në Vajmar. Por ky qytet ka fatin e madh të ketë këtë natyrën dhe njerëzit me shpirt dhe identitet të spikatur. Kjo është shumë e rëndësishme, që dhe Pogradeci të mos jetë thjesht një qytet, por një qytet-ide. Fantazia e njerëzve mund ta orientojë këtë qytet edhe drejt të mirave në elementë strukturorë dhe, pse jo, edhe infrastrukturorë. Artizanati dhe mjeshtrit drapunues, mund të bëjnë сувениere me objekte të përmendura në poezitë e Lasgushit apo në rrëfenjat e Mitrushit.

Po ashtu, në pëmishten e mbjellë me pemët - "monument i poezisë dhe prozës" nga ata që janë sot krenaria jonë dhe e gjithë shqiptarisë, duhet të mos ketë

shkurre, driza e hithra, ndaj, nuk duhet bërë kompromis me mediokritetin letrar. Këtu, më pak se kudogjetkë, nuk duhet të bashkëjetojnë format impotente e të pavlera të të sotmes, me madhësinë e gjenialitetin e lirikës së Poradecit, dhe rrëfenjës së Kutelit. Mua më ngazëlleshni iniciativat e motivimit të lexuesve, në tepër se sa ato të shkruesve të poezive. Më mirë të kemi më shumë lexues të mirë, se sa më shumë poetë të dobët, që nuk sjellin zë origjinal e s'janë mbresëlënëse jashtë kufijve të qytetit, e aq më pak të vendit.

Filozofi kanadez Charles Taylor, rilindi në një këndvështrim aktual problematikën e vlerave, duke parë lidhjen e teorisë së vlerave me teorinë e formimit të identitetit të brendshëm, si dhe aftësinë për t'u vetëvlerësuar. Këtë duhet ta bëjë gjithkush në Pogradec, kur mbaron së shkruari. Poezia e Lasgushit nuk mund të jetë më shtrati, që ne të shtrijmë pafundësisht artikullimin e ndjenjave tona. Dhe, nëse ritheksoj edukimin e lexuesit dhe vëzhgimeve të tij kritike, mendoj se ai, më tepër nga gjithkush, duhet t'u përgjigjet prurjeve letrare bashkëkohore, e jo të vazhdojë të lexojë si gjithmonë ato pak vepra standarde, por të edukojë reflekse të reja të të lexuarit, në bashkëlidhje me prurjet e reja moderne letrare.

vijon në faqen 5

-14 operacione të sukseshme, 10 grupe krimianale të goditura

Policia e Korçës bën bilancin e vitit

Në analizën e punës një vjeçare të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Qarkut të Korçës mori pjesë zv/drejtori i përgjithshëm i Policisë Rasim Boriçi. Drejtorja Rajonale e Policisë së Qarkut të Korçës ka zhvilluar analizën e punës njëvjeçare. Në bilancin e këtij viti nga janë evidentuar si suksese të punës 14 operacione të sukseshme, ku asnjëri prej tyre nuk ka patur dështim. Operacionet e koduara dhe të ndërmarra nga kjo drejtori janë realizuar me një shkallë të lartë

profesionalizmi.

Po nga kjo polici janë goditur 10 grupe kriminale, ku janë prangosur 208 persona.

Në fjalën e rastit, drejtuesi i Drejtorisë Rajonale të Policisë së Qarkut të Korçës Emri Vata, falënderoi mediat elektronike dhe ato të shkruara për pasqyrimin e punës së policisë.

Vata, theksoi edhe bashkëpunimin e frytshëm mes policisë kufitare dhe asaj të mbrojtjes nga zjarri. Në punën e

përditshme të kësaj policie janë shënuar 868 vepra të ndryshme penale, ku shkalla e zbulueshmërisë ka qenë 87 për qind ose 3 për qind më lart se viti i kaluar. Janë zbuluar dhe janë vënë para përgjegjesisë ligjore persona për 784 vepra penale.

Njëkohësisht kreu i bluve shpalosi dhe proiritetet e vitit 2009, ku në plan të parë janë parandalimi i veprimtarive kriminale dhe mbrojtja e interesave të individit. Duke qenë se Korça është dhe një zonë që frekuentohet nga shumë turistë në të gjithë stinët e vitit, Vata vuri në dukje se nuk ka patur shqetësime apo ankime nga turistët, duke falënderuar punonjësit e policisë për gatishmërinë e lartë që kanë treguar edhe në këtë drejtim.

Për muajt e verës ka patur një gatishmëri dhe bashkëpunim me

punonjësit e zjarrfikseve për shuarjen e zjarreve dhe zbulimin e autorëve të vënies së zjarreve.

Krahasuar me vitin 2007 në Qarkun e Korçës ka një rritje me 230 vepra penale, por është rritur forca zbuluese. Rritja, sqaroi Vata, nuk ka ardhur si rezultat i shtimit të veprimtarive kriminale, por si rezultat i evidencimit edhe i ngjarjeve më të rëndomta, të cilat janë marrë në konsideratë nga policia.

Një vëmendje të veçantë policia i ka kushtuar edhe sektorit që mbulon dhunën në familje dhe proklet e të miturve. Gjatë vitit 2008 janë ndaluar 77 të mitur, ku 12 prej tyre kanë kërkuar mbrojtje ligjore. Veprat penale të të miturve kanë qenë më të shumtat vjedhje e grabitje prone.

P.Çuni

Pogradeci: një qytet-ide?

vijon nga faqja 4

Një tjetër filozof i shquar, i shkollës së Frankfurtit, Jürgen Habermas e shpjegon këtë refleks të ri të të lexuarit, dalë nga qendra e të ashtuquajturës "sferë private", si përçues më pas të një rrjeti të dendur të "komunikimit publik".

"Sfera e publikut do të shërbejë, nga ana tjetër, si zgjerim dhe si plotësim i sferës së intimitetit të familjes së vogël. Dhoma e fjetjes (privatja), dhe salloni i pritjes (publikja) gjenden në të njëjtën çati; dhe dëshmojnë si publike e njëjës ashtu edhe private e tjetrës. "Kështu", thotë Habermas, "subjektiviteti i njeriut lidhet me publicitetin e këtij subjektiviteti, njësoj siç janë të përmbledhura në letërsinë fikzionale dhe njeriu formohet për të qenë pjesë e publikut."

Ja, kjo do të ishte pak a shumë, argumentuar së fundmi mes mendimeve të Habermasit, ideja ime, për ta shndërruar qytetarin pasiv të Pogradecit, në pjesë aktive të publikut dhe shqetësimeve të tij. Kjo do të kishte edhe efekte në zhvillimin e qytetit, që jo vetëm gjoli të pastrohet, por, bashkë me të, burimi dhe muza e artit dhe shpirtit të poradecarit.

Një nder më shumë

Në prani të dhjetra qytetarëve korçarë, me pjesëmarrjen e pushtetarëve lokalë, u zhvillua ceremonia e dorëzimit të titullit "Qytetar Nderi i Korçës" Imzot Joanit, për veprimtarinë e tij në të mirë të komunitetit. Fjalën e rastit e mbajti At Ilia Kotnani, i cili përshkroi në mënyrë të detajuar veprimtarinë e Imzot Joanit, qysh në momentin që iu kushtuar fesë.

Lindi në vitin 1956 në qytetin e Tiranës. I apasionuar pas historisë, studion shkencën e neuro-psikiatrisë. Karrierën fetare e nis duke u bërë murg, më vonë prift dhe në vitin 1998 fronëzohet peshkop. Në vitin 1990 mbaron studimet në Boston të Amerikës me rezultate të larta, gjithashtu përfundon edhe masterin, po në Boston, për studime teologjike. Johanin e shohim mësues teologjie, kurse në vitin 1996 nderohet me titullin Arqimandrit.

Në revistën që boton "Orthodhoksia Korçare", njihemi me botime dhe përkthime të ndryshme që kanë autorësinë e Imzot Joanit. Ai tregon një kujdes të veçantë për njerëzit në nevojë.

Klinika shëndetësore e ngritur nën kujdesin e tij është e pajisur me aparatura të reja, aty ilaçet jepen falas. Në mencën për të



varfërit ofrohet ushqim falas për 100 veta. Gjithashtu shpërndahen dru zjarri për 40-50 familje në nevojë.

Shtëpia e Foshnjës ka ndierë dorën e ngrohtë të tij me ndihma në ushqime, veshmbathje dhe ilaçe. Me rastin e Vitit të Ri ai shpërndan lodrat për fëmijët e familjeve të varfra. Ndhimesa e

Imzot Joanit shtrihet edhe tek fëmijët me të meta dhe tek të moshuarit pa përkrahje. Ai është ideatori i ndërtimit të një azili për të moshuarit e vetmuar.

Në ceremoni përshëndetën kryetari i Bashkisë, zoti Niko Peleshi dhe kryetari i Këshillit të Qarkut, zoti Ilia Milo, të cilët vunë theksin në marrëdhëniet e mira me mitropolitin. Në përshëndetjen në emër të intelektualëve korçarë u vu theksi në përgatitjen erudite të tij dhe tek inteligjenca e kultivuar me punë e dashuri. Tek kryqi Imzot Joani gjeti vetveten, u tha aty. Të duash Zotin, do të thotë të duash Atdheun.

Ai ka vënë në shërbim të njerëzimit gjithë dashurinë e tij, gjithë dijet.

Eshtë projektuar prej tij ngritja e një shkolle të mesme. Sanatoriumi me ndihmat e siguruar nga Imzot Johani, do të ofrojë kushte edhe më të mira për të sëmurët. Por kujdesi i tij ka qenë i pranishëm edhe në sektorin e kulturës. Ishte Imzot Joani që ofroi sallën poshtë katedrales, ku sot japin shfaqje profesionistë e amatorë, fëmijë e të rinj.

A.Pepi, aktor

Iku dhe një vit

Viti 2008 u mbyll, po si? Bashkia e Korçës në kalendarin artistiko-sportiv kishte rreshtuar edhe një aktivitet me shkollat e mesme të qytetit, dancin sportiv. Po kush e përgatiti këtë aktivitet që zhvillohet për herë të parë në qytetin e Korçës? Asnjë mësues i edukatës fizike nuk e njeh këtë kërcim. Qendra Kulturore e fëmijëve bëri përpjekje para disa vitesh të krijonte dy grupe të dancit sportiv, por nuk arriti rezultatin e duhur sepse specialistët e edukatës sportive, ndonëse gjimnastë, nuk e njihnin tangon.

Duhej punuar që në fillim të vitit shkollor nga specialistët, me nxënës të zgjedhur. Kontigjenti është i konsiderueshëm, ka shkolla të mesme të përgjithshme e profesionale, Universiteti "Fan S.Noli" me mjaft degë. Të mos harrojmë shkollat 9-vjeçare që janë jo pak, po 12. Por më 22 dhjetor u paraqitën vetëm 3 shkolla të mesme: "R.Qirinxhi", "F.Konica" dhe "Y.Dishnica". Juria ishte e përbërë nga mësues të edukatës sportive, kryetari i shoqatës së dancit klasik dhe një ekonomiste. Mungonin specialistët e vërtetë të dancit A.Bratko, E.Sinollari, B.Pojani si dhe më i riu J.Asabella, gjimnastët e talentuar K.Pula, Ll.Pula si dhe Y.Pulaha e të tjerë që kanë dhe titullin Mjeshtër Sporti.

Nëse duhet t'i jepni rinisë një aktivitet, jepini specialistët e duhur dhe kohën e përgatitjes. Një spektakël ka një platformë ku duhet të zhvillohet, ka një libret të shkruar nga njerëz me përvojë. Ka një regjisor që ndërton spektaklin duke harmonizuar elementët e tij. Por një spektakël ka edhe spektatorët, që ta shijojnë, ta vlerësojnë dhe të frymëzohen prej tij për të ecur më tej. Ka edhe një spiker që lidh spektaklin.

Të gjitha këto i munguan spektaklit. Por e keqja nuk mbaron këtu: edhe ata nxënës që debutuan para një salle të zbrazët, nesër nuk do të jenë prezent në këto aktivitete, të zhgënjyer nga organizatorët.

Ilda Pepi, nxënëse e shkollës "R.Qirinxhi", Korçë

Bukuri që vret sheh në çdo qelizë të qytetit.



Lypësit mbledhin shpërblimin

Një mëngjes i ftohtë siberian dhe migjenian. Rrugët e trotualet e Korçës janë spërkatur me brymë. Me brymë një ditë më parë. Sot bora dhe akulli i ka veshur me kostumin e tyre. Temperatura shënon minus 5. Por në përshëndetjet e tyre njerëzit shprehin se është nën minus 5. Ftohtë që në mëngjes. Kur ende nuk janë hapur dyert e administratës, fëmijë të mitur e kanë nisur turin për të mbledhur shpërblimet për vitin e ri dhe pas hyrjes në forcë të vitit me 365 ditë, që ende nuk ka ngrënë as dy apo tri dreka.

Fëmijët kanë mbërthyer kyçet e rrugëve kryesore. Që herët prindërit apo menaxherët e tyre i kanë nxjerrë në mes të acarit. U kanë përgatitur këndin e punës. Për shtroje u kanë vendosur kartona dhe i kanë mbështjellë këmbët dhe trupin me pelerina e xhupa. Vetëm sytë janë të hapur dhe duart që zgjaten që në orët e para të mëngjesit me lutjen, të vetme lutje që do ta përsërisin gjatë gjithë ditës: "Të lutem, o xhaxhi nëm njëqind leka". Bashkë me fjalët nga goja del dhe avull që duket sikur i mbyltingujt. Orë pas ore manaxherët venë dhe i kontrollojnë. Marrin ato pak monedha metalike që ata kanë fituar duke lënë mbi banak të tyre një apo dy pesë lekëshe. "Edhe këta kanë nisur të qahen se nuk fitojnë asgjë", - thumbon një i dehur me volkë edhe ky që në orët e para të ditës. Përpara bibliotekës së qytetit të Korçës, para pallatit të kulturës fëmijë të ngujuar mbi asfalt. Pak më tej gjenden bankomatet e disa bankave.

Prej tyre nuk nxirren lekë të vogla. Nuk kemi të shkoqura, shfajësohen kalimtarët që nuk kanë e nuk duan të japin lëshime për këta fëmijë lypës. Janë të komunitetin rom a egjiptian. Nuk i dallon dot nga maskimi që u kanë bërë. Në një lokal nisin e tregohen barcaleta. Hyjnë dhe aty lypës ambulantë që shëtitin sa në një derë në tjerën. "Një ditë më parë po pinim tek lokali i luleve. Për humor, kurrsesi për ta fyer i nxjerrim një njëmijë lekëshe një lypësi duke i thënë se ja këtë kemi, nuk kemi të shkoqura. Por ai me zgjuarsi e shpejtësi na i ktheu se ai ua kthente reston pasi të mbante vetëm 50 lekë. Menduam se edhe lypësi po na bënte karshillëk. Shkoqe, po këtu ama para syve tanë. Nga çorapet nxori lekët prej letre. Nga xhepat e pantallonave ato prej metali.

Si të dehur që ishim ia shtuam racionin duke i dhënë 100 lekë. I dhamë dhe bakshish për thyerjen e lekëve që na bëri. Kjo ndodhi dje" - e mbyll barcaletën një kolegu ynë mësues. Por ai ngul këmbë se nuk është e sajuar, është origjinale, e jetuar dje dhe që vazhdon të jetojë edhe në çeljen e ditës së sotme. Edhe të ditës së nesërme.

Po sot në këtë mëngjes të spërkatur me brymë, kur këta të mitur që rrinë si të ngrirë, që nuk i njohin paratë se duken që nuk janë më tepër se 4 vjeç, si do të eci bursa e lypjes. A ka dhe bursë të tillë? Ka të tillë ky qytet. Vetëm të tillë se nuk njihet bursë e tipit tjetër.

Pushtetarët hapin zyrat. Ngrohin godinën me frymë dhe me kondicioner. Llogarisin se ku do ta kalojnë fundvitin. Po dhe veç një shpërblimi të miratuar nga qeveria dhe një shpërblim nga vetë institucioni.

Jashtë zyre fryn era e lypësve dhe e varfërisë. "E hëngrët rrogën?" - ngacmojmë një mësues poet. Rrogën ende s'na i kanë dhënë, por siç duket do të hamë shpërblimet këtë vit më parë se rrogën. Me dy shpërblime jemi bërë këtë vit. Një qeveria dhjetë mijë lekë dhe një drejtorja me gjashtë mijë lekë. Kur merr shpërblime s'ke ç'e do rrogën", - reciton mësuesi i matematikës.

Bukuri që vret sheh në çdo qelizë të qytetit. Edhe atje ku shkëlqejnë vilat, vriten sytë e lypësve, që kalojnë anash ose përballen nga kalime të pakontrolluara. Edhe ai pronari prej vërteti flet me vete, kur ecën në krah të pronës së gjyshit, por që ende nuk e ka marrë se ia kanë zënë të tjerët e nuk e dorëzojnë. Dhe pronari mbledh e mbledh dëshmi e dokumenta të reja e të vjetra e i bën bashkë e bluan ujë në gjykatë. Edhe ai i persekutori ruhet ende nga persekutori se nuk ka pushtet. Pushtetin e mban gjallë ende persekutori. Damarët e persekutorit janë shtrirë sa gjerë e gjatë, si rrap madhështor mbi l(l)umin e demokrac(z)isë. Dje humbëm rininë e pasurinë. Nuk dimë se ç'po humbasim sot, nuk dimë... Dimë që nuk dimë të ecim si duhet. Mbase edhe ai lypësi i mitur. Ata lypës të spërkatur me brymë e dinë apo nuk e dinë se do të dalë dielli. Ata duan që t'u mbushet xhepi që t'u mbushet pak barku. Sikur nuk ka atë lezetin e duhur qyteti pa praninë e këtyre lypësve të mitur apo të rritur.

Pak më tutje të mbytin reklamën për oferta luksoze. Në hell dridhen pula e qengja. Dridhen dhe këta lypës nga të ftohtit. Dridhet qyteti nga qejfi. Fishekzjarre që zbrazen ku të mundin. Krisma dhe tym. Kënaqësi e blerë. Po të dalësh mbi kodra dhe pikërisht tek "Kristali" sheh qytetin të mbytur nga smogu i fishekzjarreve. Aksi kryesor i veshur me akull. Nuk u kujtua bashkia që të hidhte pak kripë për ta shkrirë. Edhe akulli është pjesë më vete e qytetit. Ata të pastrim gjelbërimin festojnë diku. Nuk kanë fonde për të hedhur dy grushta me kripë. Në ditët e verës fondet bëhen aheng e berrë. Tani në dimër nuk gjen lekë për të blerë një thes me kripë të zezë për të shkrirë pak akull që të rrezikon në çdo kalim që bën.

P.Çuni

Ajo është fotografi e vetme që kemi tani për atë qendër arsimore që lojti një rol aq të rëndësishëm për mësimin e gjuhës shqipe

Kush e fotografoi "Mësonjëtoaren e Parë Shqipe"

Nga Apostol Bitraku

Sa herë shohim fotografinë e "Mësonjëtoares së Parë Shqipe të Korçës" që u hap në vitin 1887, mendja na shkon tek autori i saj, tek fotografi që me aq emocion shkrepri aparatën fotografik, mbi njëqind e ca vjet më parë dhe na la ne sot një kujtim aq të çmuar dhe me vlerë. Ajo është fotografi e vetme që kemi tani për atë qendër arsimore që lojti një rol aq të rëndësishëm për mësimin e gjuhës shqipe, me të cilën krenohet jo vetëm Korça, po dhe mbarë vendi. Fotografi që realizoi atë fotografi ishte atdhetari Kristo Panajot Shuli (Sulidhi) një nga fotografët më të hershëm ose babai i fotografisë shqiptare siç e ka quajtur një studiues i kohëve tona. Themi atdhetar se veprimtaria e tij para dhe pasi bëri fotografinë, ishte e dukshme në shërbim të vendit. Në fotografinë që është vendosur në brendësi të këtij shkrimi duken qartë, duke filluar nga e majta në të djathtë, kujdestari i shkollës, i mirënjohuri Kristo Vodica, pranë pusit, pastaj nxënësit dhe në të djathtë disa nga mësuesit e shkollës së asaj kohe.

Kristo Shuli lindi në vitin 1858 në fshatin Marjan të zonës së Oparit, rrethi i Korçës, në një familje me tradita atdhetdashëse. Pas disa vitesh, kur Kristoja ishte ende i vogël, familja e tij u shpërgul nga fshati dhe u vendos me banim të përhershëm në Korçë. Pastaj ai u largua nga familja dhe shkoi në Greqi dhe në Francë, ku u shkollua dhe mësoi edhe profesionin e fotografit. E kishte me pasion fotografinë dhe punonte shumë për të. Po kishte pasion edhe letërsinë dhe u mor për një kohë me vargëzimin. Vjershat e para, herë ua lexonte shokëve dhe të afërmëve, herë jo, siç veprojnë shpesh të rinjtë kur janë në fillimet e krijimtarisë letrare të tyre. Aty në Greqi ai hyri në marrëdhënie të ngushta me mjaft patriotë shqiptarë, sidomos me atdhetarin Anastas Kullurioti që botonte në Athinë gazetën "Zëri i Shqipërisë". Ai u bë krah i djathtë i tij dhe në atë gazetë shkruante edhe vetë artikuj të ndryshëm, duke i firmosur herë me



emrin e tij të plotë, herë me inicialet H.P.S. Aty ai botoi edhe vjershën e tij të gjatë prej 150 vargësh, një balladë luftarake të titulluar "Shqiptarët që luftojnë në Guci". Ishte koha kur luftohej për mbrojtjen e tokave tona në Plavë e Guci nga synimet shoviniste të vendeve fqinj. Vargjet e tij janë luftarakë, bëjnë thirrje për kushttrim. Midis të tjerave ai shkruan: Bjeri o Shqiptar, përsëri bjeri/ Atij Karadaku, bjeri/. Pasi ndenji disa vjet në Greqi, gjithmonë me aparatën fotografik me vete, mori një udhëtim nëpër kolonitë shqiptare të Stambollit, Egjiptit dhe Bukureshtit. Edhe në këto vende veprimtaria e tij atdhetare nuk u ndërpre dhe ai propagandon hapur nevojën e bashkimit të popullit për të fitur lirinë dhe domosdoshmërinë e mësimin të gjuhës shqipe. I armatosur me këto ide, u kthye në vendin e tij, në Korçë para vitit 1900. Këtu iu fut punës së fotografit. Punonte shumë dhe të gjithë e njihnin fotografin patriot, njeriun e urtë e të sjellshëm që bënte fotografi të cilësisë së lartë. Në studion e tij që e kishte ngritur në oborrin e shtëpisë, vinin të gjithë për fotografi, vinin të kamurit po edhe ata që ishin dorëhollë, populli i thjeshtë. Në këto takime që kishte me njerëzit, në mjaft raste ai ndante fshehur edhe libra e abetare shqipe që i vinin nga shoqëritë patriotike jashtë atdheut. Kristo Shuli ishte i pranishëm në të gjitha ngjarjet dhe veprimtaritë e ndryshme që zhvilloheshin në Korçë në ato vite. Në këto veprimtari ai

fotografonte momentet më të rëndësishme dhe njerëzit që ishin protagonistë të tyre. Kur Gjerajim Qiriazhi hapi në Korçë shkollën e vashave, ai ishte aty. Bëri një tog fotografish dhe fiksoi momentet me rëndësi historike, të cilat kanë arritur deri ne ditët e sotme. Jo vetëm kaq, po ai e përkrahu dhe e ndihmoi me të gjitha mundësitë Gjerajim Qiriazin në veprimtarinë e tij. Fotografi Kristo Shuli ishte i pasionuar edhe pas natyrës së bukur shqiptare. Ai fotografoi të gjitha rrugët dhe rrugicat e Korçës si dhe njerëzit e thjeshtë që haste aty, duke filluar që nga fëmijët që loznin nëpër to, të moshuarit që rrinin nëpër sofatet e portave, kurbatkat që shisnin shoshat dhe shportat e tyre etj. Objekt i fotografive të tij ishin edhe vendet e dëgjura dhe piktoreske të rrethit të Korçës si Voskopoja, Dardha, liqeni i Pogradecit etj. Veçanërisht atë e tërhiqte vendlindja e tij, Opari, me ato shtëpitë karakteristike të mbuluara me plloça, me ujrat dhe burimet e ftohta, me objektet e kultit, me Ostrovicën madhështore. Edhe sot e kësaj dite në mjaft familje korçare ruhen fotografi të Kristo Shulit të para vitit 1900. Ja, kemi parasysh një pamje të fshatit Marjan, fotografinë që titullohet "Shtëpia e Shkëmbit" po në Marjan etj. Me aparatën e tij fotografik ai ka fiksuar shpesh edhe portretet e kaçakëve të Shahin

Matrakut me gunat supeve dhe martinat në krahë, mik e shok me të cilët ishte. Po kështu, në studion e tij ruheshin të gjitha negativet në pllaka xhami të të gjitha fotografive që kishte bërë jo vetëm brenda vendit, po edhe jashtë tij në vendet ku kishte qenë. Fotografitë e tij ishin të cilësisë së lartë dhe për qartësinë e tyre, pozicionin, sfondin ku i vendoste të pozuarit, ishin krijime të vërteta artistike. Shpesh, piktori i dëgjuar korçar Vangjush Mio thoshte se arti i pikturave të mia zbehet përpara artit të fotografive të tij.

Pas vitit 1890 Kristo Shuli e hasim në Shkodër. Edhe aty punoi si fotograf dhe nuk e ndërpreu veprimtarinë e tij atdhetare. Ai e vazhdonte korrespondencën me patriotin Jani Vreto dhe ra në kontakt edhe me patriotë të tjerë si dhe me fotografët e dëgjuar shkodranë Marubi dhe me Kolë Idromeno. Pasi kaloi disa vjet atje, u kthye përsëri në Korçë dhe vazhdoi profesionin e fotografit deri në fund të jetës së tij. Kristo Shuli për një kohë të gjatë punoi në Korçë edhe me kunatin e tij, fotografin tjetër të dëgjuar korçar Kristaq Sotirin, i cili e vazhdoi profesionin për 40 vjet dhe realizoi mijra fotografi. Të dy këta, edhe sot në Korçë, kujtohen dhe mbahen si fotografët më të mirë. Kanë kaluar vite që atëherë, po edhe sot, megjithë teknikën më të lartë e kushtet më të mira, përsëri fotografët e sotëm nuk e kanë arritur cilësinë e fotove të Sulidhit dhe të Kristaq Sotirit.

Kristo Shuli ka pasur edhe një veprimtari tjetër të shënuar. Që kur ishte i ri ai ishte në shërbim të Misionit Ungjillor duke u bërë kështu propagandist i zjarrtë i ndjenjave kombëtare. Por jeta e tij, me tërë këtë punë, me tërë këto lëvizje dhe sidomos veprimtaria e tij patriotike, ranë në sy dhe ngjallën mërinë e patrikanës së Stambollit dhe të qeveritarëve turq të atëhershëm, të cilët e ndoqën hap pas hapi. Për veprimet e tij kombëtare u mallkua nga kisha e Fanarit dhe u mbiquajt Kriso Masoni. Dhe kisha e shpuri aq thellë ndjekjen e saj sa kur i vdiq një djalë 20-vjeçar nuk pranoi t'i jepte lejen për ta varrosur në varrezat e qytetit, gjë kjo shumë e rëndë për mentalitetin e kohës. Leja mund t'i jepej në qoftë se Kristoja ripagëzohej që të lante mëkatet ndaj kishës. Po ai nuk pranoi dhe, me lot në sy, e varrosi të birin në kopështin e shtëpisë.

Kristo Shuli vdiq në maj të vitit 1938 në moshën 80-vjeçare. Populli i Korçës e përcolli atë me nderim e respekt të veçantë.

Shkruan: Ben Andoni

Vija e pronës, që tash përfaqësohet me një mur, është fill ngjitur me buzët e oxhakut. Motiv për... Vitorio de Sikën. Kështu, ka ndodhur dhe me të tjerët, pranë liqenit në këtë rrugicë të mrekullueshme, që të sjell imazhin e qytetit të para Luftës së Madhe. "Anipse, jam mirë,-na thotë-që andej. Nuk dua të bëj reklamë. Kushdo që vjen, e gjen". Burri e ka përshtatur këtë lokal në rrugën e këndshme pedonale që lidh rrugën po gati-pedonale buzë liqenit me rrugën paralel saj dhe që natën ka një ndriçim të mirë. E shtruar bukur, aty është i gjithë sharmi i Pogradecit të vogël. Shtëpitë e vogla qytetare, të kornizuara këndshëm tek dritaret drejtkëndore dhe shtëpitë që janë pa shumë pretendime. Suvatë e rëna, telat gjithandej dhe pemët e vogla. Nga oxhaqet ka filluar tymi. Përtej qelqeve të dritareve Lule dhe çentro. Lule kudo. Dantella të pastra, që duken që tej. Oborre të vogla, nga ku ndonjë amvisë bën punët e fundit mëngjesore. Ky peizazh i përkorë urban prishet nga kënga qytetare e burrit. Ka një lepur të vrarë, në kuzhinë, që po e përgatit për drekë. Anash ka vendosur disa perime. Bulmet. Pak rrëmuje, por është i pastër.

Pogradeci i vjetër

Të gjitha këto të bëjnë grishjen kulinare të qytetit, ndërsa tej dritareve, qetësia të jep Pogradecin e vjetër. Kjo magji vazhdon deri në dalje veriperëndimore të qytetit, andej, nga ku një ngrehinë e madhe plastike, kryen funksionet e një diskoje verore. Shpendët dikush i ka trembur. Janë ngritur të gjithë fluturimthi. Të patrazuar duken këta shpendë, që u ngjajnë mjellmave. Kurse gjethet vijojnë të lëshohen. Është një Pogradec tjetër nën peshën e tyre. Djali, që na ka dhënë dhomat në hotel, na ka thënë se është bukur kur fryn pak nga liqeni. Është i edukuar, ashtu si janë masivisht në Pogradec. E shijojmë këtë, kur gjethet vazhdojnë të bëjnë lojnat e tyre dredharake ndër ajri. Ajo i jep sharmin qytetit edhe muzën dikur Lasgushit, që rri ende i patrazuar në lulishte: Mendim i qetuar/ Kujtim i trazuar,/Një flak'e harbuar,/Një vash'e pushtuar,/Një zjarr i shkruaruar,/ Plot iskra pa shuar. Sharmi i vjeshtë-dimrit është kudo buzë liqenit. Ajo të pushton fill tre orë pasi ke ardhur nga 139 kilometrat e Tiranës. Njësoj kur vjen nga Republika e Maqedonisë në Pogradec, kur futesh nga Tushemishti, që është 5 kilometra nga qyteti dhe Qafë Thana që është vetëm 25 kilometra, Pogradeci të këndell. Kryeqytetasit tash ia dinë vlerën, sepse në fundjavë një mori makinash



Prag-dimri zbret në Pogradec

përshkojnë distancën për të pushuar aty. Shikojmë shumë kryeqytetas syresh. Edhe ata ne. Bashkia ka rregulluar një rrugë përpara, ndërsa ndryshe nga vite më parë pogradecarët janë bindur se burimi i tyre i vetëm ka mbetur turizmi. Të rinjtë-meshkuj, vazhdojnë te llotot. Sa shumë syresh. Kjo është shëmtia e vërtetë e poezisë dhe përtacia e tyre. Vajzat performojnë, si dikur në bulevardin e qytetit. Ka ardhur burri. Mesdita jonë, që në fakt i bie një mëngjes për të, është e këndshme. Ka një bukë të mrekullueshme dhe e di se vetëm me edukatë do grishi njerëz. Ka tre kthina në shtëpinë e tij restorant. Në njërin vinë vendas, që u ka rënë thjesht rruga; në dy të tjerat këndellen miqtë. "I bëj gjërat me porosi", -na thotë krenar. Ka një amalgamë të tërë gjërash të vjetra, që i shkojnë një shtëpie qytetare, me bazë tradite. Një tryezë e ulët me dru. Një kanistër për bukën...Fruta. Pjata të mëdha. Si ai, dhe pak të tjerë, kanë filluar që të bëjnë turizmin familjar dhe synimi është i qartë: kjo është e ardhmja e qytetit. Turizmin e ndjen kudo. Te çmimet normale në restorante, te gatimi i pastër, te menuja e pastër...dhe te edukata. Ajo duket edhe më e ndjerë në këtë vjeshtë të vonë. Burri hedh sërish ndonjë vështrim nga kthina. I kënaqet oreksit tonë. Nga tutje sobat përmes oxhakëve

shpërndajnë në etër aromën e këndshme të drurit të djegur. Kështu i paqtë ka zbritur agu i dimrit mbi qytetin e liqenit.

Varkat

Burri, që nuk ka qejf t'ia përmendin emrin, ka muhabet të këndshëm. 63 vjeçar. Është i këndshëm dhe me humorin e një njeriu që gjërat i shkojnë mbroth. Tutje janë nisur varkat. Ata janë simbolet e kësaj paqësie dhe njësoj si Nositët, emblemat e pagoja të qytetit. Ato nisen në darkë, ato nisen në mëngjes. Ka ndodhur që të mos vinë më dhe atëherë qyteti ka pasur një vdekje. Një vdekje, që i ngjan vdekjes së Nositit. Pastaj, e kanë kujtuar burrin. Pastaj familja, qyteti, i është kthyer të përditshmes, qyteti jetës me një brengë më shumë. Pak kohë, pasi jemi ndarë me burrin, shikojmë sesi një i vogël imiton një peshkatar përtej, që po sistemon një rrijetë. Ai bën pikë për pikë, atë që i madhi po mundohet të rregullojë me kujdes. E imiton këndshëm. Varka u është gjendur shumë pogradecarëve. Në një shkrim të Tomi Matos, që është botuar te Nositi i Afroviti Gushos, rrefehet sesi peshkonin ata dhe uleshin më tej dallëndyshet në varkë. Si u flisnin atyre. Gjemi apo kore quheshin...dhe i pari që e solli gjeminë ishte një peshkatar i vjetër me emrin Maxhun nga Ohri, që më

“

Njësoj kur vjen nga Republika e Maqedonisë në Pogradec, kur futesh nga Tushemishti, që është 5 kilometra nga qyteti dhe Qafë Thana që është vetëm 25 kilometra, Pogradeci të këndell. Kryeqytetasit tash ia dinë vlerën, sepse në fundjavë një mori makinash përshkojnë distancën për të pushuar aty. Shikojmë shumë kryeqytetas syresh. Edhe ata ne. Bashkia ka rregulluar një rrugë përpara, ndërsa ndryshe nga vite më parë pogradecarët janë bindur se burimi i tyre i vetëm ka mbetur turizmi.

1919. Ky erdhi familjarisht, thuhet në një kronikë qytetëse. Gjemia ishte një varkë tetë metra e gjatë dhe 2.20 e gjerë dhe gati 1.20 e lartë. E punonin zakonisht katër vetë: lopataxhinjtë dhe njëri që mbante dyzenë (timonin). Gjemia shërbente për treglinë e qytetit dhe lehtësonte shkëmbimin ekonomik të qytetit dikur. Kështu p.sh. gazeta KOHA, që është botuar më 16 shtator në Korçës do të shkruante se "...në liqenin e Ohrit u mbyt një gjemi me shtatë vetë: dy tregtarë nga Pogradeci, një ushtar serb dhe katër lopatexhinj". Një teknologji më vete ishte dhe bërja e tyre me dru gështenje. Në një farë mënyre, varka ishte simboli i mbijetesës së qytetit, por edhe i angazhimit të tyre. Me një të tillë syresh do të arratisesh Familja Fejzollari nga Pogradeci. Plot 16 veta në një ditë të errët...Varka e tyre, tashmë e ruajtur në një muze në shtetin përballë, tregon sesi e kundërshtuan regjimin, pogradecarët. Ajo varkë ishte me një skelet prej dërrase harkuar si kjo...në dysheme kishte disa dërrasa që lidhnin krahët me shtresën e poshtme. Anët ishin të mbështjellë me mbulesë tavoline. Ishte e gjatë 3 metra, e gjerë 1,50 e lartë 060 metra. Ishin djemtë e Kushes që dërguan matanë plot 16 veta. Thonë se e solli si ide një projektues frëng, por në liqen e lëshoi një pogradecar. Sotir Koçi Shkurti, ideatori i saj vdiq më 1981, duke ia lënë këtë traditë qytetarëve të tij. Ato që ndërtonin me dru bredhi jetonin 3-4 vjet dhe aspak më shumë. Kurse mjeshttrat e Ohrit, Terpezicës, Peshtanit ngritën varkat e tjera prej llamarine. Sot në qytet janë Safet Llangozi, Mondi Bashua, Sotiraq Matua. Në Rrëmenj është Fatmir Xhemollari, i referohemi Z.Mato. Kjo është pak a shumë historia e varkës. Në rrugën buzë liqenit janë shtuar këmbësorët, ndërsa djali ikën dhe burri me varkë ende nuk ia ka vënë re,

Pogradeci nuk është i famshëm vetëm për gjolin magjistar

Prag-dimri zbret në Pogradec

kujdesin. Ai punon që në mbrëmje të lëshohet në liqen, ndërsa djali për ëndrën...

Pensionistët dhe Karnavalet

Ëndrra e këtij qyteti është një përzierje e imazhit gati flu të natyrës, liqenit, njerëzve të saj dhe qytetit të vjetër. Pogradeci të çudit me qetësinë e banorëve të saj. Ka qenë një e tillë gjithmonë. Regjimi e bëri disi të ngurtë, këtë simbiozë të njerëzve me natyrën, por nuk mundi të futej më tej. Materia nuk e përballoi idenë në këtë rast. I "vetmi" ngazëllim i tepruar i qytetarëve ishte koha e karnavaleve, një festë që u hoq pas Luftës së Dytë. Karnavalet fillonin të organizuara dhe Disiplina në rrugë ishte tejet e përkorë. Ishte vetë bashkia, e cila caktonte një njeri, që do merrej me rendin e njerëzve... Përmbys, o jetë, /M'i fal stolitë:/ Kujtim të qetë, /Plot zjarr, plot dritë, e përjetësoi Lasgushi. Këta të moshuar, që baresin kudo me kasketat e tyre, janë kudo. Kanë një humor shumë fin, që i shkon gjuhës së tyre të mbushur me zanoret e këndshme dhe gjithmonë edhe krija e qytetit. Ata e mbajnë të vjetër, por edhe e kanë ruajtur qytetin. Ata i japin tisin me sepje të vjetërsisë. Jo më kot, kryetari i bashkisë, duket se e ka mbushur qytetin me stola të bukur, që shikojnë liqenin, ndërsa një pastërti shembullore të ndjek kudo. Njësoj ka qenë dhe kohë të shkuara... Që nga Kisha e Fjetjes së Shën Mërisë fillonte korteu që vazhdonte pastaj deri më tutje... Hyska ishte tellalli, që shënonte fillimin e festës së karnavaleve, pastaj fillonin ata me veglat dhe korteu vazhdonte në rrugë. I gjithë qyteti e përshëndeste varganin me karnavalet, ndërsa pijetarët që nga klubet, u ngrinin gotat në nderim. Të tjerë, pastaj, imitonin çifte. Hipnin në gomarë dhe këndonin dhe vallëzonin. Tek Luadhi i Ydri beut, sot një nga lulishtet pranë liqenit, mbledheshin pastaj për t'u argëtuar të gjithë. Goditëshin gjërat e këqija zakonet dhe shpesh edhe shkëmbeshin batuta me njëri-tjetrin. Pjesa e tretë ishte muzgu, kur njerëzit shkonin për vizita duke uruar Kreshmë të Lehta, sepse vinte koha që njerëzit nuk do hanin më bulmet dhe vezë dhe gjellët dhe brumërat do gatuheshin me vaj. I gostinin amvisat karnavalet me gliko, llokume, raki dhe verë, pastaj shtroheshin sërish në muhabete. Karnavalet shkonin në shtëpitë e atyre që kishin fëmijë për të

martuar dhe nuk i linin të shkonin në Kishën e Shën Prokopit. Një javë para Pashkëve vajzat mendonin për Llazoret. Sillnin peshqirët, shamitë e mëndafshit etj. Dilnin duke kënduar: Moj e ëma e djalit, ku më je Llazore. Atëherë mikpritësja do t'u jepte një grusht miell, pak gjalpë dhe çfarë ti ndodhej. Kjo ishte një festë, ku kombinohej aq bukur kënga, vallja humori dhe elementët e tjerë. Tregojnë njëherë se aq e fortë ishte kjo në besueshmërinë popullore, sa që kur iu lutën për shi natyrës... një vit- një ditë më vonë ra shi. Kjo shpurë e madhe njerëzish të gëzuar shkundte letargjinë e qytetit, derisa në vend të saj pllakosën vetëm festat politike. Ato i hoqën me



përdhunë nga kujtesa historike dhe nga hipoteka qytetare. Ashtu si hoqën dhe Llazoret, Ruzicat, të Verës... Këto tradita tash kanë ikur. Në vend të tyre kanë ardhur festa të tjera. Nuk ka më karnavale, por qyteti është duke u përpjekur të ngjallë të vjetrën. Prej vitesh bëhet festa e liqenit dhe pak nga pak është bërë në institucion. Pleqtë, që na kanë baritur pranë, tash kanë zënë një vend dhe luajnë domino. Dikush letra. Ndërsa një grup të moshuarash e derdhin shikimin tek një çift, që fotografon pareshtur njëri-tjetrin. Një femër e bukur, me një trikuart të bardhë, përshkruar me vargëzime të zeza, që i pozon liqenit dhe që mundohet t'i japë fytyrën fokusit së të dashurit...

Pogradeci-Retrospektivë

Dhe, llaf pas llafi, hymë në Pogradec ose Poradec, siç i thotë Lasgushi, i cili

“

Ëndrra e këtij qyteti është një përzierje e imazhit gati flu të natyrës, liqenit, njerëzve të saj dhe qytetit të vjetër. Pogradeci të çudit me qetësinë e banorëve të saj. Ka qenë një e tillë gjithmonë. Regjimi e bëri disi të ngurtë, këtë simbiozë të njerëzve me natyrën, por nuk mundi të futej më tej.

”

një hotel modern, godinë stil kubist, me dhoma të mëdha, elektrik, ujë të rrjedhshëm nëpër dhoma, banjë, restorant dhe gjithë lehtësirat moderne. Një hotel, i cili, edhe sikur të përjashtoj faktin kryesor në çdo dhomë ka ballkon me perspektivë nga liqeni dhe malet, prapë do të ishte, edhe brënda në Tiranë, hotel luksi... Ditën do të freskohen në tallazet e kristalta të liqenit. Dhe netët me hënëz-netët verore të Pogradecit janë shkëputur nga përrallat e moçme me Ora, Fatmira dhe të Bukura të Dheut-barkarola në liqen, me kitara dhe mandolina! Bashkia e Pogradecit punon. Punon pareshtur me takt, me sistem, me mend. Bulevardi që hapi gjatë buzëgjollit, është një buri. Për të qenë e plotë kjo vepër duhet që edhe sheshi përpara Hotelit të zgjerohet e të zbukurohet. Në anën e sipërme të Sheshit është një kopsht i Vakëfit-më parë vend varrezash. Mësuam se vetë xhamia është gati, pa pretendime, t'ia falë qytetit një copë të këtij kopshti-deri në drejtim të rrugës-që vjen nga e majta. Nuk e di nëse punon..., shkruante 80 vjet më parë, publicisti Gjergj Bubani.

Është ditë tjetër sot. Duhet të ikim. Në darkë kemi hasur shkrodranët që i kënaqen sërish me potere qytetit. Dhe, ai burri fjalaman që mban sërish fjalë të gjata patetike. Mësueset, që përflasin... mbase jo më burrat dhe vjehrrat... dhe zhurmën. Për qytetarët e Pogradecit kjo është e tepërt. Djemtë... po shikojnë në kafe-llotot Serinë A dhe pak u bën përshtypje. Por, për vjeshtën e Pogradecit kjo është tepër. Ajo nuk duron dot më shumë. I mjaftojnë ulickat e ngushta, zogjtë, mjellmat, shtëpitë, kasketat e të vjetërve... dhe tutje ai Lasgushi. Burri ka pasur bajagi klientë sot dhe na buzëqesh që përtej xhamit, duke na grishur sërish për nesër. Mungime-e ndryshime, /Ndryshime-e dredhime, /Dh'ato gjarpërime- /Hon për zemrën t'ime. Çifti i rrotullohet Lasgushit. Ajo e gëzuar. Ai në pezm. "Sa patetik, ky. Duket si Aleksandri i Madh, me pallto", i thotë djali. Ajo qesh e lumtur... E përqesh. Pastaj i kthehet vjeshtës. I qesh jetës. Ne largohemi. Shpendët zbresin mbi liqen. Mjellmat shtrihen. Shoferi i një furgoni nga Korça na thërret çjerrazi, ndërsa një grup fshatarësh, në barkun e furgonit të tij- janë të mbledhur tok, duke përfolur dimrin. Ka ardhur prag dimri në Pogradecin e bukur.

Vargjet i takojnë Lasgush Poradecit. Është shfrytëzuar udhëpërshkrimi i Gjergj Bubanit për Pogradecin në vitet '20 të shekullit të shkuar dhe artikuj të marrë nga gazeta "Nositi", që përgatitet nga Znj. Afrovitë Gusho.

Në fund të fundit, çdo krijues është interesant për të veçantën e tij në të ndjerë, në të menduar dhe në të shkruar


Në çarkun e një krijuesi

Vangjush Ziko

Arti i krijimit është aq i lashtë sa dhe lashtësia e pasionit dhe e mençurisë njerëzore. Në të njëjtën kohë, ai është aq i ndryshëm, sa të ndryshme janë natyrat, karakteret njerëzore. E rëndësishme është të gjesh në krijimtari vetveten dhe të kumtosh me lexuesit me zërin tënd, qoftë dhe me zë bretkoce, kur thoshte Eseninini. Në fund të fundit, çdo krijues është interesant për të veçantën e tij në të ndjerë, në të menduar dhe në të shkruar, veçori e cila përbën "çarkun" me të cilin ai e "kap" lexuesin e vet. Agim Bacelli ka vite që shkruan dhe boton në vendlindje dhe në mërgim. Së fundi, ai doli me dy libra të rinj: "Një kauboj në Nju Jork" dhe "Në çarkun e puthjeve"; botuar nga "D.I.J.A-Poradeci". Në të dy librat, për mendimin tim, kemi të njëjtin "kauboj". Emri i kaubojt në botë, është i lidhur me hobiin e tij për aventura trimërie dhe dashurie. Të paktën, brezi im, që nuk pat qenë ndonjëherë në Teksas,

kështu i njeh kaubojtë nga filmat bardhezi që shfaqeshin në kinemanë "Majestik" të qytetit tim juglindor. Këtu në kontinentin amerikan po njihemi dhe po shijojmë folklorin e tyre, muzikën country. Kështu që një kauboj i guximshëm në veprime dhe në fjalë, apo i kapur në "çarkun e puthjeve" është një gjetje realiste dhe me humor. Heroi lirik i vëllimit me poezi "...Në çarkun e puthjeve" është vërtet një kauboj që nuk i trembet syri nga asgjë, "sido të jenë puthjet, të jem rob i tyre qenka thënë/ s'mendoj aspak se në çarkun e pabesë jam zënë" ("Në çarkun e puthjeve"). Dashuria për të është si era që s'pyet asnjë pengesë edhe "nëse kalon në flijim" ("Si është dashuria"). Për të dashuria është "hëm lule e bukur/ hëm njeri" ("Kush je ti?"). "Mendjen e kam OK, për dreq/ e më thotë, tek zemra mos shko!/ Shpirti, një meteorolog i keq,/i thotë zemrës, dashuro!" ("Kontradikta ime")

sepse shpesh herë "gruaja ndërron/ është i marrë kush e beson" ("Gruaja"). Intensiteti i ndjenjave të këtij kauboj shqiptar ka një diagramë plot zigzage: adhurim, flijim, mosbesim, revoltim, pendim... Ai e kalon kohën duke kalëruar nëpër "prairie" të jetës me llason e tij në dorë duke gjuajtur



dashurinë, por, shpesh e hedh lakun e kësaj llosoje në qafën e vet ("Femër"). Pra, kemi një hero lirik dhe të dashuruar dhe të penduar, fitimtar dhe viktimë.

Edhe në temat e tjera (veç asaj të dashurisë) ky hero lirik mbetet po ai: dhe beson dhe dyshon në miqësinë apo virtutin, në të papriturat e çarkut të jetës. Vetëm në një gjë ai nuk lëkundet, në besimin në Zoti, "jam premtim i Zotit/ jam mirësia e tij në stuhi" ("Fjalët e ylberit") dhe në rolin edukues të artit "si një xhakëtë shpëtimi" (Poeti alkimist). Në krijimet e këtij vëllimi mbetet në qendër njeriu me kërsërinë, naivitetin, habinë apo zemërimin për vete dhe për të tjerët. "Njeriu është vëlla binjak/ Me të uruarën ujë.../ Njeriu dhe uji marrin formë sipas vendit" (Njeriu & uji). Ai nuk gjen qetësi dhe ekuilibër as në vetvete, "dora e majtë shan dorën e djathtë" ("Duart"). Në këtë

bashkëjetesë të kundërtash "qëndron kuptimi i jetës" ("Kundërshtitë e jetës"); "cirkut të jetës nuk i largohemi dot" ("Të lidhur pas hunjve të jetës"). Paradoksi qesharak qëndron në atë se njeriu nuk i kupton këto (pabesinë, tradhëtinë, ligësinë, zemërimin) dhe vazhdon t'i përsëritë sepse, fatalisht, "mëkati trashëgohet" dhe kauboj i Bacellit bën fajtores për këtë Evën biblike ("A jemi mëkatarë"). Gjëja më e bukur për këtë kauboj mbetet ajo që njeriu s'e ka arritur akoma ("Më e bukura") dhe më e keqja është se njeriu e kalon çdo kufi të sjelljes dhe të moralit kur e flak tutje frerin që "i vihet njeriut/ të mos bëhet kafshë" ("Freri"). Autori, duke përsiatuar për individin, nuk rri pa e mprehur satirën edhe për vetë bashkësinë shoqërore, "populli që vjedh dhe vidhet/ është një popull i ashpër dhe fatkeq" ("Vendi im"). Humori i autorit kalon kështu në një autokritikë të dhimbshme fataliste kur heton realitetin e vendit të vet dhe vë re se monstrës së përmbysur, diktaturës "katilë, mizore... xhelate pa maskë" nuk i janë shkukur akoma rrënjët dhe ajo, duke u struktur në ndërjegjen e pashëruar të njerëzve, ironizon sfiduese, "jam mes jush, nuk më shikoni?!" ("Ku shkove, diktaturë?"). Rrënjët e së keqes, mendon autori, duhen kërkuar, në radhë të parë, në vetja (individ dhe kolektiv), në perversitetet dhe në cenet e natyrës njerëzore, në "njerëzit si derra... që kënetave lahen çdo mëngjes" dhe, nga ligësia e tyre, fëlliqin edhe të pafajshmit ("Njerëzit si derra") dhe në njerëzit "e mirë", të cilëve u hedh krahun për t'i ndihmuar në nevojë dhe, kur bëhen të zotë të fluturojnë vetë, në vend të mirënjohjes, "të lenë një glasë" në pragun e dritares mikpritëse ("Zogu që mbajta në shtëpi"). Librin në prozë, "Një kauboj në Nju Jork", mund ta quaj, pa ngurim, një vazhdim ideotematik të librit në poezi. Vetëm me një ndryshim. Ndryshimi ka të bëjë me formën e krijimtarisë dhe me mjetet stilistike të të shprehurit dhe me distancimin e këndvështrimit emocional. Kauboj i

“

Paradoksi qesharak qëndron në atë se njeriu nuk i kupton këto (pabesinë, tradhëtinë, ligësinë, zemërimin) dhe vazhdon t'i përsëritë sepse, fatalisht, "mëkati trashëgohet" dhe kauboj i Bacellit bën fajtores për këtë Evën biblike ("A jemi mëkatarë"). Gjëja më e bukur për këtë kauboj mbetet ajo që njeriu s'e ka arritur akoma ("Më e bukura") dhe më e keqja është se njeriu e kalon çdo kufi të sjelljes dhe të moralit kur e flak tutje frerin që "i vihet njeriut/ të mos bëhet kafshë" ("Freri").

”

Bacellit, në këtë vëllim në prozë, nuk kap më me llason e tij vetveten, por personazhe të ndryshme të shoqërisë, të shtresave të ndryshme të saj (qytetarë, fshatarë, pleq e të rinj, meshkuj dhe femra, politikanë dhe njerëz të thjeshtë, punonjës të rendit dhe shërbëtorë të fesë, njerëz të ligjit dhe të shkencës, pijanecë dhe leshko) pra, një galeri të tërë personazhesh jetësorë. Këta me fjalët apo me veprimet, me mënyrat dhe me bëmat e tyre naive apo perverse, me karakteret e dobëta apo djallëzore, me dinakërinë apo me ligësinë e tyre e venë veten në pozita dhe situata qesharake në familje, në shoqëri, në kafene apo në parlament. Autori, në këtë libër, zotëron artin e këndshëm të ritregimit, ku ndjehet ndikimi i stilit të tregimtarit gojor të meseleve. Ai ka ditur jo vetëm të krijojë anekdota dhe tregime humoristike të shkurtra, por edhe të tregojë ndodhi reale e të përshtatë ose të përkthejë materiale humoristike nga gjuhë e huaj, duke sendërtuar një "album" harmonik. Të dyja këto vepra (në gjini të ndryshme) janë vazhdim i njëra-tjetrës për nga lënda estetike, këndvështrimi emocional dhe për nga nervi qytetar. Ato i lidh filli i përbashkët, mënyra se si autori e percepton kategorinë estetike të së shëmtuarës në jetën personale dhe në atë shoqërore. Por vëllimet kanë, sigurisht, veçoritë e tyre stilistike, që varen nga raporti midis subjektit edhe objektit të krijimit.

Vijon në faqen 12

TREGIM

Nga Bedri Alimehmeti

Sa herë më bie të kaloj tek kjo rrugë, ndalem për një çast buzë trotuarit dhe hedh vështrimin tek pallatet e lartë, ndën këmbët e të cilëve tashmë shtrihet imazhi i asaj mëhallës së vjetër, që çuditërisht më shfaqet i tëri përpara syve. Rrugicat e ngushta shtruar me kalldrëm, shtëpitë e ulta tiranase mbështetur sup më sup me njëra tjetrën, aq ngrohtësisht rrethuar me avllitë e qerpiçta pas të cilave lëkundeshin degët e manave, kajsave, kumbullave, hurmave e kundërmonite erë e trëndafilave, shkartzur me aromën e karafilave dhe të selfijonit. Në veshë më trokëllin rrapëllimë e nallaneve të gjyshes nëpër kalldrëm tok me melodinë e ëmbël të këngës “Rugica e ngushtë”, aq të njohur të atyre viteve, që autorët sikur e kishin krijuar enkas për mua dhe për Nezin....

“...në rrugicën tonë të ngushtë, është një vajzë e bukur shumë, është e bukur sy larushë, që çdo natë më lë pa gjumë...”

Oh, ç’ mall kam për ato sy larushë, që me vezullimin e tyre ishin të pakrahasueshëm me askërkënd në botë!

Dhe me nanuritjen e refrenit:
**“...vajzën shumë e dashuroj
Për të, unë dua të këndoj....”**

Eca më tej nëpër kalldrëmin e rrugicës. Ja porta e shtëpisë time brejtur nga motet e shumta dhe pak më tej, porta e saj. O Zot po ç’ më ka zemra kështu?! Përse më rreh kaq fort? Thua se po m’i thyen brinjët, e po më del jasht kraharorit! Po portën kush e hapi? Oh, po si nuk u ndje fare! Ajo gjithnjë kërciste kur hapej, i rënkoni menteshat, burgitë... Po Nezi aty qenka ende, duke larë rroba në atë govatën e drunjtë, mbi pllakën e gurit thyer përgjysëm. Si nuk mbaruan një herë tërë ato ndërresa të vëllezërve e motrave të saj më të vegjël, që ia coptuan dhe ia rreshkën fare ato duar të bukura ende të njoma. Ajo qesh sapo më sheh dhe buzëqeshja më shumë i ndrin në sytë larushë, se sa në buzët e trëndafilta. Fshin shkumën e duarve dhe më afrohet si gjithnjë me hapin e lehtë, që si cikët fare në gurët e oborrit, ndërkohë që flokët e



Dy fjalë që nuk arrita të të thoja

verdhe i dallgëzojnë supeve të përkulur, si degët e asaj vishnjes, që kishin atje në fund të oborrit, nën hijen e së cilës ne uleshim shpesh mbi ato stolat e drunjtë, duke lexuar romane mbasditëve, deri sa binte muzgu i mbrëmjes dhe pastaj nisim e diskutonim për heronjtë tanë më të dashur.

- Ç’ libër më ke sjellë? - ishte zëri i saj që më përmendi. O Zot po ç’ është kjo ngrohtësi, që buron nga ky timbër i mrekullueshëm!

- Ua po ti ç’ ke kështu?! Sa të janë skuqur sytë! Apo nuk ke fjetur?

- As një minutë.

- Po përse?

Drita e syve të Nezit ma përkëdhel gjithë fytyrën.

- Nuk më la ky - i them duke i lënë në dorë romanin e Remarkut “Tre shokë” - shumë faqe janë ende të njoma nga lotët e mi.

- Nga lotët e tu?! Kaq shumë e ke ndërë?

- Jashtëzakonisht.

- O Zot edhe unë sa punë që kam sot! Po ku e gjete?

- Dje mbasdite e bleva tek ajo libreria, pranë dyqanit të luleve tek “Broduej”. Në darkë vonë nisa të lexoj, por nuk munda ta lëshoj nga dora. Më “hëngri” të tërin, por edhe unë e “hëngra”. Kur ngrita kokën

nga libri, rrezet e para të agimit sapo kishin feksur dhe Patris Holmani...

- Kush është kjo?

- Heroina e romanit.

- Të lutem eja ma trego, ti e sheh se sa punë kam.

Sytë larushë më luten, kujtojnë se do hezitohet, kujtojnë se ndofta nuk pranoj dhe kush, unë, që dua të rri përjetësisht pranë tyre! Dhe mbështetur aty tek gryka e pusit me vështrimin të mbrëthyer tek duart e saj, që herë dilnin e herë futeshin në ujin e sapunisur të govatës, nisa t’i flas për dashurinë e madhe të Patit me Robin, pa qenë i zoti t’i them Nezit të paktën dy fjalë aq të shtrenjta, që ma çukitnin zemrën, si të ishin dy harabela që ma pengonin frymëmarrjen dhe ma mblidhnin gulsh në kraharor. O Zot si nuk munda t’ia them kurrë ato dy fjalë!

Herë pas here ajo drejtonte shtatin e përkryer, me ato përsosmëri të paarrtshme kurbash, teksa hepimi i gjinjve ndën bluzën me lule të dala boje, por të pastër akull, më rrëmben shikimin dhe me mend recitoj vargjet që enkas kam thurrur për të: “...flokë yt si mëndafsh, të mbulon gush’e gj...”.

Vallë a kam lënë ndonjë nga këto pjesë të hajthshme të këtij trupi të mrekullueshëm pa i thurrur vargje?

Po si mund të rri pa shkrojtur për këto sy larushë vezullues, për këto flokë dallgëzues, për këtë bel të këputur unazë, për këto këmbë të harmonishme, (që nën shtrëngimin e kilotave të atllaztë vishnje, i bënin shumë nga djemtë e klasave më të larta të gjimnazit, të futeshin me vonesë në mësim kur ne kishim orën e fiskulturës) për këtë aromë dehëse, kundërmonjëse....

Dhe i flas e i flas pambarimisht, për Robin, për dashurinë e tij të pastër dhe i deklamoj thuajse fjalë për fjalë, thëniet e zjarrta dashurore në adresë të Patris Holmanit, bukuroshes fatkeqe gjermane, pa qenë i zoti t’i them kurrësi ato dy fjalë, aq të shtrenjta, të përsëritura mijra herë në brendësi të shpirtit tim: “Të dua”. “Të dua”, “Të dua”, jo më për t’i deklamuar një të vetmin nga ata qindra vargje të shkruara enkas për të....

Po ç’ është gjithë kjo zhurmë?! Ç’ është kjo lëvizje, ç’ duan gjithë këto njerëz në rrugicën tonë! Po Nezi ç’ u bë?! Kush ma mori? Ajo ishte me mua, ja atje pranë pusit. Oh, ç’ është kështu?! Po bien dajre, muzikë! Kush martohet sot në rrugicën tonë?! Po Nezi ç’ bën atje në krye të shkallëve? Ç’ është ai fustan aq i bukur, e aq i bardhë që paska veshur! Sytë e saj larushë kërkohjnë të më gjejnë mua në mes të asaj turme gazmore njerëzish të mahnitur prej bukurisë së saj, teksa nga qerpikët i shkasin dy pikëza loti si smeraldë, si një qortim, që nuk qesh i zoti t’ia thoja kurrë ato dy fjalë....

Kisha humbur i tëri në detin e përmallshëm të këtij përjetimi, kur ndjeva dikë të më prekë në sup: “Xhaxha mos ndofta nuk ndjeheni mirë?”. Kthej kokën dhe çuditërisht pranë meje qëndron një gjimnaziste sy larushë me flokë të verdhë dallgëzonjës mbi supet e brishtë. Nezi! Jo, jo tashmë bashkë me imazhin e mëhallës së vjetër është zhdukur ajo e gjithçka. Kanë kaluar kaq vite që atëhere! Kujtimi i asaj vajze të bukur tiranase, që nuk arrita kurrë t’ia thoja ato dy fjalë, jeton ende aty në thellësi të shpirtit tim edhe në këto vite të pleqërisë, sa herë më bie të kaloj andej, më pëlqen ta përjetoj atë kohë, vetëm për pak. Si vezullim i një vegimi....

Në çarkun e një krijuesi

Vijon nga faqja 10

Në prozë autori na "tregon" indiferent, kurse në vjershat na "tregon" nëpërmjet përjetimeve të heroit lirik. Në prozat, humori dhe satira përcillen drejtpërdrejt nëpërmjet gjuhës narrative të autorit ose dialogeve dhe situatave konkrete, që janë të pasura plot aforizma dhe shprehje plot kripë të folklorit të jetës së përditshme. Në fund të çdo pjese, në prozë, kemi gjithmonë një mendim edukues që i bën jehonë filozofisë popullore dhe moralit të shëndoshë. Edhe në vjershat, jo rrallë, autori e zgjidh qëndrimin ideomocional nëpërmjet moralizimit në mbyllje të tyre, gjë që i afron më shumë këto krijime me fabulën se sa me poezinë lirike të mirëfilltë. Duke mbisunduar në këto vjersha humori apo satira, ndodh, për mendimin tim (kam parasysh vetëm këtë vëllim në poezi), ajo që ndodh dhe në natyrë me aromën e lule manushaqes që mbin pranë hithkës së hidhur. Kjo, sigurisht, është zgjedhja stilistike që ka bërë vetë autori në këtë vëllim, zgjedhje e cila, për mua, është sa subjektive aq edhe objektive. Është subjektive sepse lidhet me natyrën e karakterit letrar, karakter i cili çastet intime i shikon me një sy vetëqesëndisës, duke i mbetur besnik kredos së vet, që përmenda më sipër. Ai e kërkon të shëmtuarën më parë në vetja e vet, pastaj në tjetri apo në shoqëria. Ndërsa, ana objektive lidhet me misionin që i ka caktuar vetes, fshikullimin e së shëmtuarës në jetë. Ai e di që "plagën" e shëron jodi dhe jo parfumi; prandaj dhe "manushaqka" mbetet kokëmënjë nën hijerëndën dhe erëhidhurën "hithkë". Kjo është "terapia" që ka zgjedhur autori.

Të dyja këto vepra janë arritje në krijimtarinë e Agim Bacellit. Dhe, për mendimin tim, shprehin një preferencë potenciale të krijimtarisë së tij, e cila po e tërheq për nga "korja humorndjellëse" në procesin e tij krijues, "kore" e cila të bën të qeshësh, të kënaq artistikisht dhe të çlodh shpirtërisht. Kjo "kore" më joshi dhe më "kapi" edhe mua në "çarkun" e krijimtarisë së tij.

Dhjetor, 2008

FRAGMENT

Ina Cici

Maturante, shkolla "Lasgush Poradeci"

...Nuk e kuptoj se çfarë po ndodh por zemra po më pëshpërit si për të mos dashur të dëgjojë askush që po vjen për tek ty. Po më përgatit që të mbledh të gjitha forcat që i kam falur dikur me dashuri, sepse nëse nuk kam forcë nuk mund të vij drejt teje...

I jam ulur në gjunjë kësaj zemre që mos më bëjë të ndihem keq por ajo paska qenë e pamëshirshme... I jam lutur me shpirt që mos më drejtojë nga ty, por ajo bën me dashurinë më të madhe. Jam munduar të mos mendoj më për ty, jam munduar mos të dua më, por nga këto mësova se paska dhe gjëra, të cilat janë të pamundura në jetë. Ndoshta jam vërtet e vogël, por dashuria paska një forcë të paimagjinueshme rritëse. Dikush më mësoi dikur se mosha më e bukur është fëmijëria dhe më vjen keq që e kam humbur atë duke menduar se doja dikë, kur në fakt ishte thjesht një miku im. E mallkoj veten çdo çast që nuk mund të jem me ty... e adhuroj me shpirt çastin që të desha për herë të parë dhe shpresoj që kurrë të mos ketë një herë të fundit... e vetmja arsye që dua t'i them lamtumirë jetës është se nuk mund të jem me ty. Besomë i dashur, nuk mundem më. Një jetë kam që dhuroj dashuri, por vetëm për ty të gjeta që të mundesh të ma kthesh atë me sinqeritet... dhe në momentin që të gjeta, më duhej të të humbisja. Dhe ashtu ndodhi vërtet. Të kam humbur dhe arsyeja e vetme është sepse jo vetëm unë, por çdokush do përjetonte më shumë një fund me dhimbje se një dhimbje pa fund...

E bashkuar në atë anije kërkimtare piratësh unë guxoja dhe kërkoja thesarin më të madh e kisha në duart e mia. E shtrëngoja fort dhe e fshihja nga të tjerët se tani ndryshe nga ç'na ndodh ndonjëherë në jetë e dija se çfarë kisha në duar. Kisha një kujtim tëndin, me të cilin zgjohesha çdo mëngjes dhe flija çdo mbrëmje. E ruaja fort se mos largoheshe nga lotët e mi, të cilët më shoqëronin në shumicën e mbrëmjeve gjithnjë që ndieja mungesën tënde e përqafoja sikur ajo të ishte ti. Dhe vërtet ishte ajo gjithçka më ngelej... një kujtim i joti, të cilin nuk mund ta flakja tej si diçka të pavlerë. Edhe sikur të ishte e pavlerë nuk mund ta bëja këtë sepse



Falmë që të dua


fakti që ishte diçka nga ti, e bënte një thesar të kërkuar nga miliona piratë. Nëse ata do zbulonin se ajo ishte në duart e mia, do të më kishin vrarë për mosbesnikëri, por të betohem që kjo nuk ka për të ndodhur sepse ajo më përket mua.

Mos u shqetëso sepse as për veten nuk jam kujdesur ndonjëherë kaq shumë. Ata nuk kanë për të zbuluar kurrë sepse sapo i binda që të ndalojnë kërkimet. Sapo të gjej mënyrën do të largohem prej tyre. Dhe a e di se çfarë do bëj?! Do vrapoj për tek ti sepse po ndiej se po më mungon. Nuk e di pse, por po ndihem shumë e rrezikuar. Ndoshta kjo ndodh ngaqë nuk jam pranë teje, ndoshta nga mosbesimi i dashur. Nuk e di ti, por unë mund të kujtoj mjaft mirë mosbesimin tënd dhe netët e gjata që keqjetonim. Më shiko në sy. Bindu. Unë jam një hiç për të qenë në krahët e tua. Nëse do vemë në peshore gabimet tona kam frikë se unë jam më mëkatore se ti. Më tepër i trembem ndarjes në jetën e përtejme. Unë e mbaj për vete atë që ndiej për ty sepse zemra më ka kërcënuar që nëse flas, ajo do të pushojë. Edhe ajo nuk ka guxim se përderisa është e imja, është si unë.

Tani të hedh vështrimin vjedhurazi edhe pse fare mirë mund të të shoh drejt e në sy, kam vjedhur aq shumë vështrime nga sytë e tua sa edhe ti nuk pate më durim. Më denoncoi. Tani jam shpallur në kërkim prandaj duhet të tregoj kujdes nëse duhet të jem e lirë. Por njëkohësisht duhet të marr dhe frymë... që të jetoj... Por po ndihem

pa forcë, pa mbrojtje, pa dashuri. Me dhimbje të tmershme në zemër, të cilat të mallkojnë shpirtin sepse më vendosën në një udhëkryq ku m'u desh të zgjidhja vetëm një rrugë. Fatkeqësisht në atë rrugë pashë vetëm copëza lotësh të kuq që të gjithë derdhnin si unë. Sepse aty të gjithë ishin të barabartë, madje edhe unë pavarësisht asaj që mbaja në duar isha njësoj si ata. Fatkeqësisht kjo rrugë ishte pa kthim. Edhe pse u mendova muaj me radhë, po kuptoj se kam zgjedhur rrugën e gabuar sepse po ndiej që po shkoj drejt fundit...

Tani i lutem me shpirt zotit që të mos ma rrëmbejë jetën kaq shpejt edhe pse pa ty ajo nuk ka rëndësi. Më mjafton të të shoh tani. I lutem me një përgjërime që del nga shpirti që të rikthehem, por edhe ai mbron zemrën duke më përsëritur se ajo më paralajmëroi që kjo rrugë ishte pa kthim. Tani që nuk më ngelet gjë tjetër, mundohem të jetoj më kujtime sepse edhe pse në duar kam thesarin më të madh të botës, nuk mund të jem e lumtur. Kur nuk kemi atë që dëshirojmë mjaftohemi me pak. Edhe mua më duhet të shtrëngoj fort atë thesar në duar dhe të vazhdoj rrugën e jetës, sepse nëse kam atë, kam edhe një pjesë të vogël të shpirtit tënd për ty jo, sepse për të të pasur ty më duhet të shes atë thesar që më dhurove ti... ky është çmimi që duhet të paguaj... por kjo si shumë gjëra në jetë është e pamundur... Prandaj i dashur të lutem falmë... që të dua!



Libra të botuar gjatë vitit 2008




Autori	Titulli i librit	ISBN
○ Pëllumb Çuni	Tym dhe brirë fjalësh	(ISBN 978-99956-618-5-4)
○ Hajder Lilo	Konti i Monte Krabës	(ISBN 978-99956-618-6-1)
○ Mitat Lushnjari	Kujtesë e largët	(ISBN 978-99956-618-7-8)
○ Maliq Torra	Djeg ky mall	(ISBN 978-99956-618-8-5)
○ Edmond Zaçe	Vdekje e dembelosur	(ISBN 978-99956-672-1-4)
○ Maksut Çallo	Dehje Poradecare	(ISBN 978-99956-618-9-2)
○ Edmond Shallvari	Diku, dikë, dikush	(ISBN 978-99956-672-3-8)
○ Jorgji Rrushi	Veteranë	(ISBN 978-99956-672-5-2)
○ Petro Prifti	Mendime për mendimet, Unë ti	(ISBN 978-99956-672-4-5)
○ Rajda Petrela	Leshmanjoza viscerale	(ISBN 978-99956-672-2-1)
○ Pirro Piqoni	Antologji Përmbledhje poezish	(ISBN 978-99956-672-0-7)
○ P.Çuni, F.Biraku	Shamia e mbrëmjes	(ISBN 978-99956-672-6-9)
○ Agim Bacelli	Një kauboj në New York	(ISBN 978-99956-672-8-3)
○ Ziko Kapurani	Valixhja	(ISBN 978-99956-672-9-0)
○ Anastas Kostandini	Paris 07	(ISBN 978-99956-672-7-6)
○ Grup autorësh	Rebelim poetik	(ISBN 978-99956-705-2-8)
○ Bujar Braho	Brenda qënies së adoleshencës	(ISBN 978-99956-705-7-3)
○ Vangjush Ziko	Borëbardha flokëthinjur	(ISBN 978-99956-705-1-1)
○ Ilo Kotelli	Për ty Dishnicë	(ISBN 978-99956-705-3-5)
○ Agim Bacelli	Në çarku e puthjeve	(ISBN 978-99956-705-6-6)
○ Edmond Shallvari	Ç'u bëmë kështu	(ISBN 978-99956-705-4-2)
○ Arjan Kallço	Qyteti nuk u përgjigj	(ISBN 978-99956-705-5-9)
○ Pavlina Kristo	Imazhi i jetës	(ISBN 978-99956-705-0-4)
○ Ramadan Dinoshi	Krua i mërguar	(ISBN 978-99956-705-8-0)
○ Paskal Zota	Drithërimat e Zemrës	(ISBN 978-99956-705-9-7)

Libra të rinj të Sh.B. "D.I.J.A - Poradeci"



Ç'u bëmë kështu
Poezi

Autor: Edmond Shallvari
Faqe 112
Çmimi: 300 lekë




Qyteti nuk u përgjigj
Tregime

Përktheu: Arjan Kallço
Faqe 160
Çmimi: 300 lekë



Brenda qënies së
adolshencës

Tufëza esesh
Autor: Bujar Braho
Faqe 128, Çmimi: 400 lekë



Krua i mërguar
Poezi

Autor: Ramadan Dinoshi
Faqe 80
Çmimi: 300 lekë

KESHILLA

Për të patur një kuptim sa më të drejtë për menaxhimin korrekt të barnave, duhet të rikujtojmë se ato janë kimikate dhe në fund të fundit "helme". Përfundimisht helmin nga medikamenti e ndan vetëm doza. Marrja vend e pa vend si dhe marrja e një llojshmërie të madhe medikamentesh, në mënyrë të pashmangshme shkaktin fenomenin e ndotjes medikamentoze ose të rezistencës medikamentoze.

Barnat në përdorim i kemi disa llojesh. Kjo llojshmëri është e kushtëzuar nga rruga e përhithjes dhe e administrimit të tyre në organizmin e njeriut. Pra kemi në dispozicion: kokrra (të sheqerosura ose jo), kapsula, injeksione (vajore ose ujore), kashe, të tretshme në ujë, ovula dhe suposte, pomadë dhe kremra, në formë pikash, shurupe, spray, xhel etj. Kjo do të thotë që ekzistojnë një mori e madhe medikamentesh dhe rrugë administrimi të tyre në dispozicion të personelit shëndetësor për të luftuar sëmundjet, në mbrojtje të shëndetit të pacientëve.

Por këshilla e personelit mjekësor, përfshi këtu absolutisht edhe farmacistin, është që të respektohet me rreptësi rruga e marrjes së medikamenteve, pasi në shumë raste, kur nuk është respektuar ky rregull, ka ndodhur fenomeni i mbindjeshmërisë apo të quajtur ndryshe, fenomeni i reaksionit nga medikamentet.

Pavarësisht nga lloji i medikamentit, duke filluar që nga prodhimi i tij, transporti, magazinimi e deri në tregtimin e tij në farmaci, kërkohet me rigorozitet plotësimi i disa kushteve për ruajtjen e efektit të tyre farmakologjik. Së pari armiku nr.1 është lagështia, së dyti temperatura e lartë, së treti kontakti me dritën e diellit. Pra në qoftë se nuk plotësohen kushtet optimale për mënjënimin e këtyre agjentëve negativë, pak rëndësi ka data e skadimit e përmendur në etiketim.

Tjetër aspekt shumë i rëndësishëm që sa u prek pak më lart, është data e prodhimit dhe ajo e skadencës, datë që në radhë të parë duhet respektuar nga profesionistët e më pas nga masa e pacientëve apo e të afërmeve që tërheqin barna nga farmacia. Kjo datë shpjegon se pas kalimit të saj, medikamentet ose do të humbin efektin e tyre farmakologjik në atë masë sa t'i bëjë ato të papërdorshme, ose ato që ndodhen në ambalazhe sterile



Për një kulturë në menaxhimin e barnave

mund të humbin sterilitetin e garantuar.

Ekziston një rregull në sistemin farmaceutik që nuk lejon të jepet çdo lloj medikamenti pa recetë, ashtu siç ekziston edhe mania e një pjese të pacientëve që të kenë në shtëpi sa më shumë dhe një gamë të gjerë medikamentesh. Është e vërtetë që një minifarmaci shtëpiake është e domosdoshme, pasi zgjidh situata të jashtëzakonshme dhe imediate, por nga ana tjetër i gjithë personeli mjekësor duhet t'u shpjegojë pacientëve që për çdo bar që do të mbajnë në minifarmacinë e tyre shtëpiake, në mënyrë të domosdoshme duhet të këshillohen me mjekun e familjes dhe të mos i besojnë verbërisht vetëmjekimit të tyre.

Lidhur me minifarmacinë shtëpiake, porosi tjetër, rreptësisht e detyrueshme për zbatim është që kjo minifarmaci duhet të jetë e paarritshme nga fëmijët dhe e mbyllur me çelës për moshën e tretë. Për të dyja kategoritë e pacientëve të lartpërmendur, rekomandohet që medikamentet t'ua japin të tjerët e jo t'i marrin vetë, për të shmangur aksidente të mundshme.

Përsa i përket zbatimit të

Së pari armiku nr.1 është lagështia, së dyti temperatura e lartë, së treti kontakti me dritën e diellit. Pra në qoftë se nuk plotësohen kushtet optimale për mënjënimin e këtyre agjentëve negativë, pak rëndësi ka data e skadimit e përmendur në etiketim.

rekomandimit të marrjes së medikamenteve para ose pas ngrënies, në mëngjes apo në darkë, çdo 6 orë apo 8 orë, rekomandim që citohet nga mjeku i familjes dhe përsëritet nga farmacisti në momentin e dorëzimit të medikamentit, ka shumë rëndësi të respektohet me rigorozitet. Këto rekomandime kanë të bëjnë me orët biologjike të organizmit tonë, me shpejtësinë e arritjes së koncentritimit dhe jetëgjatësinë e medikamentit në gjak, si dhe me momentin më optimal për t'u përhithur nga organizmi.

Një tjetër aspekt jo më pak i rëndësishëm është kultura e pajisjes me medikamente gjatë largimit nga shtëpia për pushime. Pjesa më e madhe e të sëmurëve kronikë nuk harrojnë pa marrë me vete medikamentet e tyre. Në kundërshtim

me ta, të rinjtë apo kategori të tjera të popullsisë, të shëndetshëm, nuk kujdesen të kenë me vete medikamente, duke neglizhuar në këtë mënyrë faktin se rastësisht mund të pësojnë një dhimbje koke apo dhëmbi, një reaksion alergjik apo pickim, plagosje të lehta etj. Duke patur parasysh dhe rrjetin jo fort të dendur dhe efikas të sistemit tonë shëndetësor, kjo nevojë merr një karakter më imediat. Të njëjtën gjë do të thosha edhe për ekzistencën e paketës së urgjencës në makinat e vogla, pse jo dhe në autobusët e ekskursionistëve, por gjithmonë duke respektuar rregullin e mbajtjes në vend të freskët dhe larg dritës së diellit, psh në një termus të vogël.

Dr. Andrea Kocaqi
Mjek i familjes, Libonik, Korçë

Horoskopi javor i "Nositit"


Dashi (21.3-20.4)

Nëse gërmoni brenda jush, mund të largoni dëshpërimin. Nuk do të jeni me humor të mirë.


Peshorja (24.9-22.10)

Ju duhet të gjeni mjetin e duhur dhe të shfrytëzoni rastet për të ecur përpara në profesion.


Demi (21.4-20.5)

Do të jeni të pajisur me intuitë, së cilës duhet t'i besoni. Në biznes, situatë për të rritur fitimet.


Akrepi (23.10-22.11)

Mund të jenë vetë kolegët tuaj që t'ju vënë në dukje se meritoni diçka më shumë në profesion.


Binjakët (21.5-21.6)

Mund të jepni mbështetjen tuaj direkte për një aktivitet të ri ose për një projekt me interes.


Shigjetari (23.11-22.12)

Mund të bindni një person me ndikim t'ju bëjë një nder të madh në çështje familjare.


Gaforrja (22.6-22.7)

Do të bini dakord me personat me të cilët do të diskutoni për të kryer disa detyra të vështira.


Bricjapi (23.12-20.1)

Mos u shqetësoni nëse dikush ju shprehet se mënyra e sjelljes suaj është e papërshtatshme.


Luani (23.7-23.8)

Duhet të përballeni me shigjetat helmuese të një personi, i cili do t'ju shtyjë në situatë të vështirë.


Ujori (21.1-19.2)

Duhet t'i jepni një shtytje të mëtejshme punës për të arritur objektivat tuaja kryesore.


Virgjëresha (24.8-23.9)

Nuk duhet të mendoni vetëm për veten tuaj, por të ndihmoni edhe ata që kanë nevojë për ju.


Peshqit (20.2-20.03)

Ata që ju gjykojnë do t'ju gjejnë shumë simpatikë dhe mendojnë se meritoni më shumë.


SMS humoristike

Do të shpërndaj petale trëndafili në çdo hap që do të hedhësh, do të derdh mjaltë në rrugën tënde, do të hedh vaj të parfumuar në të gjitha shtigjet... Dreqi e mori, herët ose vonë do të rrëzohesh.

Mos e flakni profesorin nga dritarja, ambienti i pastër varet edhe nga ti.

Nëse shëmtia do të ishte një muze, ti do të ishe një Luvër.

Ti je shumë dembel, je vërtet aq dembel sa do të martohesh me një grua shtatzënë.

Të dëshiroj, dua të të marr mendtë, dua të të tërheq në shtrat, dua të ndjesh shumë nxehtësi, të të bëj të djersish dhe të dridhesh për një javë...

Të fala nga gripi.

Dashuria të bën të bësh gjëra të çmendura, unë për shembull jam martuar.

Ti ke një tru kaq të vogël, sa po të takohen dy mendime, njëri duhet të



Vipat Top Sekret

Jolie: "I mbaj fëmijët sa më larg internetit"



Fëmijëve të saj u kërkon gjithnjë të shikojnë DVD-në e "Mr. and Mrs. Smith", ndoshta dhe për t'i mbajtur sa më larg internetit, të paktën përta i përket më të madhit Maddox, 7 vjeç. Aktorja që është transferuar në Berlin për shkak të punëve që kishte Brad Pitt me Quentin Tarantino, thotë se "nuk mendon për një adoptim të ri, të paktën jo deri kur fëmijët të jenë të mirëintegruar".

Jennifer Garner, dy herë mama



36 vjeç, kanë edhe një vajzë tre vjeçe, Violet.

Aktorja Jennifer Garner u bë nënë për herë të dytë në Los Angeles. Sipas revistës "People", bebja e saj, një vajzë, emri i të cilës nuk u bë i ditur, ndodhet në gjendje të mirë shëndetësore. Garner dhe bashkëshorti i saj Ben Affleck, të dy

Ministri gay martohet

Ministri i drejtësisë angleze, përkrasës i konservatorëve të David Cameron, Nick Herbert, është martuar me të fejuarin e tij Jason Eades. Ceremonia u zhvillua në bashkinë në Lambeth, në Londër, në praninë e familjarëve më të ngushtë. Cameron i ka dërguar dhe urimet e martesës çiftit të ri. Herbert, 45 vjeç, i fejuar me Eades që nga 1999, është eksponenti i dytë homoseksual në qeveri, që gjydh një bashkim civil.



1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
12				13					14	15
		16	17					18		19
20						21			22	
		23				24		25	26	27
28	29		30					31		
32		33				34				35
		36				37		38	39	
40					41	42			43	44
			45		46			47		
			48		49			50		51
52	53	54		55						56
	57				58			59		



1-31 dhjetor
2008
Ulje çmimi për **kancelaritë**

Ofertë fantastike për të pasuruar bibliotekat tuaja:
plus
Dhuro një libër në këtë fundvit!



Enti botues
D.I.J.A. - Poradeci
Enti Botues: "D.I.J.A. Poradeci" -Pogradec
Adresa: Rruga "Rinia", Pallatet 7-katësh, Pogradec
Tel: +355 832 2905, Mobil: 069 2143753
e-mail: afrovitig@yahoo.com;
dukailir@yahoo.com

*Ne nuk shesim libra,
Ofrojmë kulture.*

Përgjigjet e fjalëkryqit të numrit të kaluar (Nr. 453)

Horizontalisht: 1.Bulb 4.Gang 7.Etiopia 13.Ri 14.Re 16.Vinçi 17.Margarita 19.Lot 20.TT 22.To 23.Partosi 24.II 25.Is 26.Trimi 28.STAS 29.Pot 30.Is 31.Ese 32.La 33.LT 35.Zt 36.Antar 37.Popi 38.Ivani 41.Vi 42.Vare 44.Ss 46.LD 47.Akra 48.Odesa 51.Tito 53.Adolf 54.KO 55.AK 58.Li 60.Sol 62.Konti 63.Balalajka
Vertikalisht: 1.Bratilava 2.Ui 3.Bratislava 5.Ana 6.Gripi 7.Evarist 8.Ti 9.Indonezi 10.Oç 11.Pilivesa 12.Antarktida 15.Eros 18.Tamizi 21.Titaniku 26.Torpedo 27.RT 34.Tra 39.Vata 40.NL 43.Rodi 45.Sto 49.Elba 50.SF 52.Oksa 53.Ali 54.Kel 56.KK 57.Sn 59.LJ 60.LU

Horizontalisht: 1.Ka kryeqytet Tripoli 5.Aktorja Xhepa 12.Nënë në Gjirokastrë 13.Aktori Paçino 14.Qyteti ku u gjykua Milosheviçi 16.Janë substancat që shpejtojnë reaksionet kimike 19.Gor, që u mund nga Xh.Bush 20.Vërtitet në vapor 21.Ho Shi... 22.Këngëtarja Konçi 23.Tërheq sendet prej hekuri 25.Aktorja Luarasi 27.Inicialet e ish futbollistit Pilika 28.Aktori Stalone, inicialet 30.Lumë në Itali 31.Andre... tenisi i njohur amerikan 32.Deti... lag brigjet perëndimore të Italisë 34.Notë muzikore 35.Inicialet e Galileit 36.Shkrimtari bullgar Pelin 37.Si nr.30 38.Futbollisti i njohur Boriçi 40.Shkrimtari gjerman Man 41.Aktori Raidhi 43.Humoristi Prodani 45.Targa e Tiranës 46.Ruhet nga policia 48.Diftongu në duel 49.Fillon mizerja 50.Eshtë... e popullit Tinka Kurti 52.Fizikani Njuton 55.Ana... këngëtare greke 56.Inicialet e aktorit Ndrenika 57.Nuk bëhet... me lepuj 58.Këngëtari Saraçi 59.Aktorja Kallamata

Vertikalisht: 1.Mefarete... këngëtare 2.Simboli kimik i indiumit 3.Aktori i njohur kosovar Fehmiu 4.Mund të jenë kontradiktat 5.Janë banorët e Valetas 6.Piktori Oseku 7.Ka një mijë kilogrami 8.Lumë në Amerikën Jugore 9.Patrioti Gërmenji 10.Ka dy vala 11.Në ishujt... bëri studime Darvini 15.Mbaron në finish 17.Kënga që këndohet e pashoqëruar nga orkestra nga një grup koral 18.Përemër vektor 24.Ka kryeqytet Xhakarta 26.Inicialet e shkrimtarit Agolli 28.Mund të jetë partiak 29.Po në Romë 33.Aktori italian Xhirone 37.Kryeqyteti i Francës 38.Basketbollistja Shehu 39.Perëndia egjiptiane e diellit 42.Duna në teke 44.Notë pakaluese 47.Këngëtarja Libohova 48.Shaban..., ka qenë volejbollist dinamovit 49.Mizat pa at 51.Inicialet e këngëtares Nini 53.Inicialet e shkrimtarit Spasse 54.Këngëtarja Take, inicialet

Botues: Ilir DUKA & Afroviti GUSHO
Në kompjuter: Edlir PODA
Lexoni gazetën në: www.poradeci.com
Gazeta shpërndahet në Qarkun Korçë

Enti Botues: "D.I.J.A. Poradeci" -Pogradec
Adresa e Redaksisë: Rruga "Rinia", Pallatet 7-katësh, Pogradec
Tel: +355 832 2905, Mobil: 069 2143753
e-mail: afrovitig@yahoo.com;
redaksianositi@yahoo.com